



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK**

Nr. 2409 / Prot. 11

Vlorë më, 22 . 12 .2023

**VENDIM**  
Nr. 62 , datë 22.12.2023

**PËR  
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË UNIVERSITETIT  
"ISMAIL QEMALI", VLORE PËR VITIN 2022-2023**


Në mbështetje të nenit 32, 38, pika 1, shkronja g, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma i, të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.5, datë 19.02.2018 "*Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afateve për raportim të institucioneve të arsimit të lartë*", i ndryshuar si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë me shkresë nr. 2398, prot datë 21.12.2023, Senati Akademik në mbledhjen e përbashkët me Bordin e Administrimit të datës 22.12.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin vjetor të veprimtarisë së Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë për vitin akademik 2022-2023 sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Vendimi i përcillet MAS sëbashku me një kopje të Raportit Vjetor të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK  
Prof.Dr. ROLAND ZISI**





REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
SENATI AKADEMIK

## ***RAPORT VJETOR***

**MBI VEPRIMTARINË E UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”  
VLORE**

**VITI AKADEMIK 2022-2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

### *Përmbajtja:*

#### **A. SENATI AKADEMIK**

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |     |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 1. Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 4   |
| 2. Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | 15  |
| 3. Te dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.....                                                                                                                                                                                                                                                                              | 23  |
| 4. Fusha Mësimdhënia.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 31  |
| 5. Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 103 |
| 6. Informacion mbi bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë IALja, të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.....                                                          | 127 |
| 7. Politikat e kërkimit shkencor.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 154 |
| 8. Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor mbi mësimdhënien.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 162 |
| 9. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit..... | 165 |
| 10. Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 302 |
| 11. Të dhëna mbi programet e studimit.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 303 |
| 12. IAL-ja pasqyron në raportin vjetor përshtatshmërinë e programeve të studimit me misionin e institucionit, realizimin e synimeve të programit të studimit nga ana e përmbajtjes dhe lidhjen e rëndësishme të programeve të studimit nisur nga vlerësimi i nevojave për aftësi në tregun e punës.....                                                                                                   | 313 |
| 13. Ndryshimet në statutin apo rregulloret e IAL-së, si dhe të dhëna për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                | 326 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|                                                                                                                                                                                                         |     |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 14. Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose modulën/et që do të zhvillojë secili prej tyre, për secilin semestër të vitit akademik.....               | 336 |
| 15. Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni..... | 347 |
| 16. Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. ....                                                  | 350 |
| 17. Të dhëna mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet drejtuese të IAL-së dhe roli i tyre në këto organe vendimarrëse.....                                                         | 354 |
| 18. Vlerësime të IAL-së dhe rekomandime të mundshme për ministrinë, si dhe një përshkrim të ndërveprimit të IAL-së me strukturat e varësisë të ministrisë.....                                          | 356 |
| 19. Të dhëna mbi studentët.....                                                                                                                                                                         | 358 |
| 20. Numri e studentëve të çregjistruar ose të transferuar, të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen.....                 | 372 |
| 21. Numrin e studentëve, që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit.....                                                       | 377 |
| 22. Pjesëmarrja e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre.....                                                                                        | 385 |

**B. BORDI I ADMINISTRIMIT**

|                                                          |     |
|----------------------------------------------------------|-----|
| 1. Plan Buxheti afatmesëm për vitet 2024-2026.....       | 402 |
| 2. Plani buxhetor njëvjeçar viti 2024.....               | 406 |
| 3. Realizimi i buxhetit viti 2022.....                   | 417 |
| 4. Shpenzimet.....                                       | 421 |
| 5. Realizimi i buxhetit Janar–Shtator 2023.....          | 431 |
| 6. Financimet e huaja.....                               | 436 |
| 7. Tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim..... | 437 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
SENATI AKADEMIK

8. Dokumentacioni i shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....443
9. Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.....444
10. Të dhëna për plotësimin e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore.....444



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

**A. SENATI AKADEMIK**

**1. Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies**

- **Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik**
- **Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse**

**Fakulteti i Shëndetit**

Politikat strategjike të Fakultetit të Shëndetit janë hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, vizionin e Universitetit të Vlorës (UV), dhe Planin Strategjik të UV. Ato fokusohen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizim, edukimin në vazhdimësi dhe ofrimin e shërbimeve komunitare.

Qëllimi i mësimdhënies në Fakultetin e Shëndetit është të formojë specialistë të lartë në fushën e infermierisë dhe kujdesit shëndetësor, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.

Në përfundim të vitit akademik 2022-2023 është e arsyeshme që të bëhet një bilanc në lidhje me arritjet e objektivave të mësimdhënies sipas Planit Strategjik të Fakultetit të Shëndetit.

**1. Realizimi i planeve mesimore në të gjitha programet Bachelor dhe Master**

Fakulteti i Shëndetit ka ofruar me kapacitet të plotë të gjitha programet Bachelor (Infermieri të Përgjithshme dhe Mami Infermieri) dhe Master (MS në Shkenca Infermirore, MP në Infermieri Patologjike, MP në Infermieri Kirurgjikale, MP në Infermieri Pediatrike), ndërkohë që anëtarë të stafit janë edhe bashkë-udhëheqës të studentëve doktorale që ndjekin studimet e tyre në universitete të huaja. Kemi ofruar për studentët të gjitha modulet semestrale të parashikuara në planet mesimore, pa krijuar zgjatje artificiale të kohës së studimeve. Kemi patur koordinim të kënaqshëm të praktikave me leksionet, duke u krijuar të gjithë studentëve hapësirat e mjaftueshme për zhvillimin e të gjitha veprimtarive mesimore.

**2. Realizimi i kohës vjetore të punës së personelit akademik të FSH**

Stafi i Fakultetit të Shëndetit ka realizuar me korrektesi kohën vjetore të punës në përputhje me marrëveshjen e orëve të punës të planifikuara dhe të realizuara e cila lidhet me fillimin e vitit të ri akademik midis personelit akademik dhe përgjegjësit të departamentit për ngarkesën e realizuar mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

### 3. Pergatitja e literatures baze dhe rishikimi i syllabuseve te lendeve ne programet mesimore

Për të gjitha modulet e ciklit Bachelor dhe për mbi 80% të moduleve të ciklit Master ka literaturë bazë të konsoliduar në dispozicion të studentëve, pjesërisht të marra nga fakultetet e Tiranës, pjesërisht cikle leksionesh të përkthyer nga pedagogët tanë. Kemi nevojë të mëdha në sigurimin e literaturës profesionale bashkëkohore dhe akses në revistat shkencore online. Titullarët e lëndëve angazhohen në rishikin dhe dorëzimin e syllabusit të lëndës para fillimit të vit akademik. Cdo ndryshim bëhet në përputhje me normativën dhe me justifikime mbështetëse nga titullari.

### 4. Hartimi i tezave të provimeve të lëndëve nga lektori i lëndës para cdo provimi

Si cdo vit akademik, lektorët e Fakultetit të Shëndetit kanë hartuar tezat e provimeve të cilat janë miratuar dhe nënshkruar paraprakisht nga titullari i lëndës dhe drejtuesit e departamenteve perkatese me qëllim transparencën, barazinë për studentët dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ky objektivi është realizuar plotësisht në vitin akademik 2022/2023.

### 5. Angazhimi i stafit akademik të kualifikuar në mesimdhënie

Nga pikëpamja e strukturës së stafit akademik / joakademik Fakulteti i Shëndetit i plotëson tashmë të gjitha standartet ligjore të strukturës së një fakulteti. Po kështu edhe të gjithë drejtuesit e zgjedhur i plotësojnë kriteret ligjore përkatëse. Numri i pedagogëve të kategorisë Profesor aktualisht vazhdon të jetë 6 pedagogë, çka përbën një bazë të sigurtë për zhvillimin e programit të doktoratës.

### 6. Integrimi i moduleve profesionale në gjuhën angleze

Në planin akademik kemi integruar module profesionale në gjuhën angleze (leksionet dhe labororet e Bazave të Infermieristikës), eksperiencë që do ta vijnë më dhe zgjerohet në të ardhmen. Kjo është një iniciativë në ndihmë të studentëve për përgatitjen për tregun ndërkombëtar të punës dhe një platformë e sigurtë për sigurimin e mobilitetit të studentëve në programet Erasmus+, ku pengesa më e madhe siç dihet është mosnjohja e gjuhës së huaj.

### 7. Edukimi universitar SMART

Edukimi SMART-Sistemi i Shërbimeve SMART- Infrastruktura SMART. Metodika e mësimdhënies ka kohë që është duke përdorur metodat audio-vizive gjë që e bën procesin më të lehtë dhe të kuptueshëm për studentët. Kjo teknologji ndërthuret dhe me metodat interaktive ku roli i studentit është aktiv jo vetëm gjatë zhvillimit të seminareve /laboratoreve por edhe gjatë zhvillimit të leksioneve. Cdo klase është e pajisur me videoprojektor fiks apo portabel. Përpjekje të vazhdueshme bëhen cdo vit për blerjen e pajisjeve të reja audio-vizive (të pasqyruara këtu edhe në zërat e buxhetit të FSH) si dhe kompletimin e laboratoreve aktual me pajisjet e duhura që do të vijnë në ndihmë të studentëve gjatë zhvillimit të praktikave laboratorike.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

### 8. Rritja e kapaciteteve te mesimdhenies nepermjet teknikave simulatore

Funksionimi efikas i laboratorit simulator bazuar në programe digitale, është në dispozicion të oreve laboratorike të studenteve, duke realizuar praktika standarte bashkëkohore me impakt në përgatitjen e studentëve për tregun e punës brenda dhe jashtë vendit. Përdorimi në mësimdhënie e laboratorit simulator ka ndikuar ndjeshëm në qasjen më të lehtë të studentëve ndaj praktikës dhe kujdesjeve infermiore. Ky laborator përdoret nga studentet e vitit të parë në lenden e INF 161&162 ku praktikojnë procedurat bazë në manekinet simulator si dhe nga studentet e vitit të tretë në lenden e praktikës profesionale ku simulohen situata dhe ndihmohen në ngritjen e planeve të kujdesjeve infermiore.

### 9. Bashkepunimi me Spitalet Rajonale per zhvillimin e praktikave mesimore

Kemi krijuar një rrjet spitalësh të shërbimit shëndetësor dytësor dhe një spital i shërbimit terciar, në funksion të kryerjes së praktikës mësimore dhe profesionale, ç'ka do ta ulë numrin e studentëve që ushtrohen nëpër reparte, duke u dhënë më tepër mundësi për praktikim individual. Kemi patur bashkëpunim shumë të mirë me Spitalet Rajonale të Vlorës dhe Fierit për zhvillimin e praktikave mësimore, ku edhe disa probleme të dala gjatë këtij procesi janë zgjidhur shpejt me mirëkuptim të dyanshëm. Edhe me insistimin e Drejtorisë së Spitalit, edhe këtë semestër i kemi zhvilluar praktikat mësimore me 2 turne (8.00-12.00 dhe 14.00-18.00) duke bërë të mundur që numri maksimal i studentëve në një pavion të mos i kalojë 20 vetë, sipas standarteve të kërkuara nga MASR.

### 10. Ndërkombëtarizimi i FSH

Marrëveshjet Kombëtare dhe ndërkombëtare që janë nënshkruar në nivel fakulteti por edhe institucional, bënë të mundur që në sajë të programeve Erasmus për mobilitetin e staf/student, disa prej studenteve perkatesisht nga DKSH dhe DI të vitit të tretë të ndiqnin semestrin Pranverë 2023 në Universitetin e Kalish në Poloni. Gjithashtu një numër i konsiderueshëm pedagogesh, anetare të 3 njësive baze, u bënë pjesë e programit Erasmus+ në *teaching* (mesimdhënie) në Thomas More University of Applied Sciences – Belgjik dhe HEALTH- MEDICAL SCIENCES, STA – Kalish, Poloni, në Academic Heroes Eëek @LSMU Programme 28-02 qeshor 2023 Caunas /Lituani, në Hellenic Mediterranean University Department of Nutrition and Dietetics Science Sitia, Greqi.

### 11. Mundësi për angazhimin ndërkombëtar të studenteve nepermjet programeve të mobilitetit

Këtë vit është rritur numri i studentëve tanë që zhvillojnë semestre akademike në Universitete Europiane (në kuadër të programeve të mobilitetit të studentëve) dhe po investohemi seriozisht për përfshirjen në projekte të tjera, në mënyrë që të rrisim sa më shumë numrin e studentëve që trajnohen në teknologjinë infermiore të standartave europiane..

### 12. Implementimi i programeve të reja mësimore





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Vlen të përmendet fakti se Fakulteti i Shendetit ka rinisur përsëri kërkesën dejt MASR për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimeve Doktoraturë në Shkencat Mjekësore si dhe është duke punuar për të aplikuar për programin bachelor në Fizioterapi.

### 13. Rritja e politikave promovuese per rregjistrimin e studenteve ne programet e studimit

Programet e studimit promovohen në panairin e tregut të punës si pjesë e Fakultetit të Shëndetit. Jo vetëm kaq, por të gjitha veprimtaritë akademike dhe kulturore të zhvilluara gjnden në faqen zyrtare të Universitetit. Vlen të përmenden edhe faqet zyrtare të rrjeteve sociale të UV dhe FSH, të cilat tregojnë më me hollësi aktivitetet tona. Efikasiteti i këtyre politikave promovuese pasqyrohen qartë me kërkesat për regjistrim në programet e studimit (te cilat edhe këtë vit ishin mbi numrin e kuotave të ofruara). Objektivi i përmbushur plotësisht.

### Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka zhvilluar përherë politika të qarta akademike, pasi ka mbajtur përherë në konsideratë prioritetet strategjike kombëtare e rajonale. Gjatë periudhës 2022-2023, strategjia që ka shërbyer si referencë zyrtare është konsideruar Strategjia e Zhvillimit të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, plani i veprimit afat shkurtër dhe afatmesëm, mbështetur përherë mbi Vizionin dhe Konceptet Strategjike të çdo departamenti.

Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore identifikohet me degët themeluese të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës (navigacion dhe inxhinieri navale) aq edhe me degët e tjera (shkenca inxhinjrike, kompjuterike, dhe shkenca natyrore).

Vizioni i FSHTN ngelet gjithmone edukimit dhe përgatitja, e profesionisteve, që mbulojnë sektorët strategjikë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar shqiptar. Në këtë menyrë ne aspirojmë të ndërtojmë një mjedis edukimi korrekt. Misioni i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore synon, zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Ky fakultet ka në fokus formimin sa më cilësor dhe profesional të aseteve njerëzore, në mënyrë që çdokush të maksimalizojë pritshmëritë e perspektivës personale dhe njëkohësisht të jetë i aftë t'u përgjigjet sfidave të zhvillimit kombëtar shqiptar.

Objektivat të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore përqëndrohet në përgatitjen e specialistëve, mësimdhënësve dhe teknikëve për fushat e: detarisë, inxhinierisë navale, mekanike dhe elektrike, teknologjisë së informacionit, informatikës, mjedisit, biologjisë, kimisë, matematikës dhe fizikës. Gjithashtu ky fakultet përgatit përmes programeve profesionale dy vjeçare, laborant kimik dhe profesionist për akuakulturen.

Prioritetet Strategjike të fakultetit tonë janë në harmoni me Strategjinë kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, dhe vendosin theksin në: rritjen e cilësisë së mësimdhënies; zhvillimin e kërkimit shkencor; edukimin në vazhdimësi; ofrimin e shërbimeve komunitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

### Fakulteti i Shkencave Humane

Fakulteti i Shkencave Humane i ushtron politikat e tij strategjike në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Planin Strategjik të UV-së, duke u përqëndruar te procesi i ndërkombëtarizimit, rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimi i kërkimit shkencor.

ë

Programet që ofrohen nga fakulteti realizohen nga stafi akademik i të katër njësive përbërëse të saj. Gati 80-90 % e programeve të studimit mbulohen nga stafi i vetë njësisë bazë, me kohë të plotë, të pjesshme e të ftuar, kurse pjesa tjetër mbulohet nga stafi i njësive bazë të po këtij fakulteti, të fakulteteve të tjera, kryesisht FSHTN-së dhe FE-së.

Organizimi dhe struktura akademike e FSHH-së përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015, neni 23 dhe udhëzimin nr. 27, date 29.12.2017 të MASR-së “Për strukturën e brendshme akademike dhe administrative të IPAL-ve”. FSHH është i organizuar në katër departamente, Gjuhët e Huaja, Edukim, Drejtësi, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi dhe ofron programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe së fundi, edhe të ciklit të tretë të studimeve: “Doktoratë” në “Studime gjuhësore, letrare e kulturore”. Programet e studimit që ofrohen nga njësitë bazë të FSHH-së synojnë përgatitjen e:

- specialistëve në fushën e gjuhësisë, letërsisë (shqipe, angleze, amerikane, italiane, botërore, të krahësuar), historisë, gjeografisë, gazetarisë, komunikimit, trashëgimisë kulturore, edukimit, pedagogjisë (së specializuar), drejtësisë, marrëdhënieve ndërkombëtare, përkthimit e interpretimit e fusha të tjera të ndërlidhura me to, në përgjigje dhe në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore, të aftë për veprimtari kërkimore-shkencore dhe për aplikime në fusha të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë, duke iu përgjigjur me kompetencë ndryshimeve të shpejta dhe zhvillimeve të teknologjisë;
- mësuesve të gjuhës shqipe dhe letërsisë, gjuhës së huaj, arsimit fillor, parashkollor, ndihmës për nevoja të veçanta, për nivelin parauniversitar (parashkollor, fillor, i mesëm i ulët, i mesëm i lartë), me nivel të lartë si nga ana shkencore ashtu dhe nga ana profesionale e mësimdhënies, të aftë për t'iu përgjigjur sfidave të arsimit dhe shoqërisë;
- kërkues të rinj në fushat e shkencave humane, kryesisht ato që ligjen me gjuhësinë, letërsinë, studimet kulturore, nënfushat e tyre, përmes hartimit dhe angazhimit të personelit akademik në projekte kërkimore dhe përfshirjes së doktorantëve në këto projekte për realizimin e programit individual në kuadër të ciklit të tretë të studimeve, por edhe përmes organizimit të veprimtarive që lidhin procesin e mësimdhënies me kërkimin (seminare, ëorkshop-e, leksione të hapura) me studentë të ciklit të parë e të dytë.

Në këtë funksion, të katër njësitë bazë të FSHH-së harmonizojnë veprimtaritë e tyre mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore, në mënyrë të mëvetësishme dhe/ose të ndërvlarur me njësitë e tjera. Vetë natyra e programeve që ofrohen në FSHH dhe veprimtaria kërkimore-shkencore dikton ndërveprimin midis



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

njësive bazë, kjo jo vetëm për shkak të fushave të përafërta që mbulojnë, por edhe në funksion të ndërdisiplinaritetit që promovojnë programet e studimit, si dhe veprimtarive shkencore ku angazhohet personeli akademik apo që organizohen në FSHH. Kështu,

- a. Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore në fusha si: gjuhë shqipe, letërsi, albanologji, komunikim dhe trashëgimi kulturore, duke synuar përgatitjen e studentëve si profesionistë të kualifikuar në drejtimet e përmendura. Kërkimi shkencor në këtë departament është i lidhur me forcimin e studimeve albanologjike, me studime në fushën e komunikimit dhe trashëgimisë kulturore. Vëmendje e veçantë po i kushtohet përfshirjes në projekte kërkimore në fusha studimi me interes kombëtar, mesdhetar, ballkanik, evropian e më gjerë. Përpos tyre, departamenti, luan një rol të veçantë në funksion të hulumtimit e të vlerësimit kulturor, administrimit të sistemeve të komunikimit e të informacionit. Në kushtet e dominimit të teknologjisë, lartësimi i dimensionit shpirtëror përmes promovimit të krijimtarisë letrare është i domosdoshëm e në këtë kuptim, departamenti është aktiv në identifikimin e autorëve të vjetër e të rinj dhe promovimin e punëve të tyre.
- b. Departamenti i Gjuhëve të Huaja zhvillon veprimtari mësimore e kërkimore që përfshijnë fusha kërkimi homogjene në disipinat mësimore përkatëse, si: gjuhësi, letërsi e studime kulturore, mësimdhënie e gjuhës së huaj, përkthim dhe interpretim, komunikim me synimin që të formojë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, përkthim dhe interpretim, komunikim, si dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushat gjuhësore, kulturore dhe letrare në përgjigje dhe në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore. Misioni kryesor i departamentit është garantimi i cilësisë dhe sigurimi i standardeve akademike për të gjitha programet e studimit, jo vetëm përmes metodave bashkëkohore, por kryesisht përmes shkëmbimit të përvojave më të mira. Në këtë kuptim, bashkëpunimi me departamente të tjera brenda dhe jashtë vendit për ndërkombëtarizimin e programeve dhe veprimtarisë shkencore, kryesisht përmes pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, mobiliteteve për stafin dhe studentët kanë mundësuar përshtatjen e programeve ndaj kërkesave të kohës, nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve dhe studentëve, mundësi për edukim gjatë gjithë jetës.
- c. Departamenti i Edukimit përfshin fusha kërkimi heterogjene nga shkenca humane dhe shkenca të edukimit. Programet mësimore bashkëkohore synojnë të formojë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie dhe të përgatisin profesionistë të rinj në disipinat e pedagogjisë, historisë, gjeografisë, në përshtatje me kërkesat e kohës. Nxitja e praktikave të mira që integrojnë mësimin me kërkimin, që përfshijnë studentët në eksperimentin të metodave novatore në trajtimin e aftësive ndryshe, si dhe ofrimi i programeve të reja, kryesisht në bashkëpunim me universitete të huaja janë në vëmendje për t'u realizuar në të ardhmen. Ofrimi i shërbimeve në funksion të të tretëve, bashkëpunime me institucione si Shkolla e Drejtorëve janë me prioritet për t'u realizuar.
- d. Departamenti i Drejtësisë zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore në fusha nga shkenca juridike dhe gjyqësore. Misioni është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të ofrojë dije përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Kjo njësi nxit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies dhe veprimtaritë kërkimore, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të departamentit.

Në tërësi, tre objektivat kryesore për vitin 2022-2023:

1. rritja e nivelit të cilësisë së mësimdhënies nga ana e personelit akademik për të mbështetur të mësuarit aktiv, mendimin kritik tek studentët, lidhjen e mësimdhënies me kërkimin shkencor, përfshirjen e studentëve në kërkim për të rritur cilësinë dhe përvetësimin e njohurive për zbatim në praktikë dhe për novacion;
2. kualifikimi i vazhdueshëm shkencor i personelit akademik dhe përmirësimi i metodave dhe teknikave të mësimdhënies;
3. përshtatja e vazhdueshme e programeve të studimit të ofruara me nevojat e tregut të brendshëm dhe të huaj;

Janë përmbushur përmes:

- a. Përmirësimi të mëtejshëm të infrastrukturës (laboratori i përkthim-interpretimit, laborator i edukimit);
- b. Përdorimi të teknologjisë së informacionit për realizimin e disa veprimtarive formuese;
- c. Përfshirjes së personelit akademik vizitor, kryesisht përmes shkëmbimeve në kuadër të programit Erasmus+. Këtë vit, përpos Departamentit të Gjuhëve të Huaja, i cili mbetet më aktiv në këtë drejtim, ka pasur më shumë shkëmbime dykahëshe edhe në departamentet e tjera;
- d. Shkëmbimit të përvojave, vendase dhe të huaja. Kjo është arritur përmes shkëmbimeve të shtuara akademike, kryesisht përmes mobiliteteve për mësimdhënie/trajnim nga ana e stafit, por edhe përmes aktiviteteve tematike në fushën e edukimit (konferenca);
- e. Organizimit të aktiviteteve shkencore nga të katër njësitë bazë, qoftë si organizatorë kryesorë, qoftë si bashkëpunëtorë;
- f. Numrit të lartë të publikimeve nga ana e personelit akademik;
- g. Numri i shtuar i aplikimeve dhe personelit që aplikon në thirrjet kombëtare dhe ndërkombëtare për projekte kërkimore dhe zhvillimore;
- h. Aplikimeve për programe të reja studimi, të cilat kanë rezultuar të suksesshme këtë vit, duke u miratuar të gjitha (programi i formimit psiko-pedagogjik, programi profesional, programi i ciklit të dytë, programi i ciklit të parë 'double degree');
- i. Riorganizimit të programeve të studimit (arsimi fillor) dhe përmirësimi të tyre (ndryshime në masën 20%) për t'u përshtatur kërkesave për përshtatje në kushtet e ndërkombëtarizimit të mëtejshëm, por edhe në funksion të përgjigjes më mirë ndaj kërkesave të tregut të punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Fakulteti ka në përbërje edhe një qendër kërkimore-shkencore, Qendrën e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike, e cila nuk është njësi bazë.

Struktura akademike e FSHH-së përfshin: asamblenë e personelit akademik që përbëhet nga stafi i të katër departamenteve, dekanati, i cili përbëhet nga dekani, dy zëvendësdekanët, një për çështjet akademike dhe një për kërkimin shkencor, dhe përgjegjësit e departamenteve.

### Fakulteti i Ekonomisë

#### Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka 9 (nëntë) staf akademik me kohë të plotë, nga të cilët 1 (një) mban titullin Profesor i Asociuar, 6 (gjashtë) mbajnë gradën Doktor Shkencash në Ekonomi, dhe 2 (dy) pedagogë sapo kanë filluar studimet e doktoraturës. Krahas angazhimit për një mësimdhënie cilësore, personeli i departamentit është i angazhuar në një punë relativisht të gjerë studimore-shkencore e botuese, në funksion të procesit mësimor, duke dhënë njëkohësisht kontribut profesional në reformimin e ekonomisë së vendit, veçanërisht në fushën e financës dhe kontabilitetit.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit fton staf akademik të kategorisë profesorë për një mësimdhënie cilësore në Ciklin e dytë të studimeve. Gjithashtu është angazhuar dhe staf akademik me kohë të pjesshme në ciklin e parë të studimeve, nga ish studentët e talentuar dhe me rezultate shumë të larta të diplomuar në Departamentin e Financës dhe Kontabilitetit. Ka 1 (një) staf ndihmës akademik sekretarinë mësimore dhe një laborante të fakultetit pranë laboratorit.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit gjatë vitit akademik 2022-2023 ka qënë i fokusuar në përmbushjen e misionit të tij që është:

Përgatitja, formimi dhe diplomimi i studentëve të aftë në fushën e *Financës dhe Kontabilitetit* në përputhje me kërkesat e tregut të punës në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin rajonal e kombëtar, por edhe në atë evropian e më gjerë. Duke ofruar një mjedis mësimor bashkëpunues që transmeton dhe zhvillon dijet nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ne edukojmë një komunitet të larmishëm të profesionistëve të financierëve dhe kontabilistëve aktualë dhe të ardhshëm për t'u përballur me sukses me sfidat e mjedisit global të biznesit për të qenë profesionistë në fushën e financës dhe kontabilitetit.

Përmes angazhimit aktiv me njesite e biznesit, jemi të përkushtuar në avancimin e të kuptuarit të financës dhe kontabilitetit dhe rolit të tyre në shoqëri, si dhe në nxitjen e sinergjive ndërmjet Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe mjedisit institucional, duke kontribuar në përgatitjen e studentëve, për t'iu përgjigjur kërkesave reale të tregut të punës duke u bërë profesionistë të orientuar ndërkombëtarisht.

Orientimi drejt rritjes së cilësisë në mësimdhënie është reflektuar në:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Rishikimin e planeve mësimore dhe përmirësim të kurrikulës së programeve të Ciklit të Parë të Studimeve: Bachelor në “Financë” dhe Bachelor në “Kontabilitet” në kuadër të plotësimit të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit,
- Punën kërkimore shkencore të personelit akademik me kohë të plotë për marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademik,
- Rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me grada shkencore, tituj akademik dhe me eksperiencë në mësimdhënie (gjatë vitit akademik 2022 – 2023 u punësuan dy personel akademik të ftuar me gradën Profesor i Assocuar dhe një me gradën Doktor, por me eksperiencë praktike për fushën që mbulon, si dhe 2 pedagogë me kohë të pjeshme me gradën Doktor)
- Përdorimi i literaturës dhe teknikave bashkëkohore dhe interaktive në mësimdhënie.
- Krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me sektorin privat dhe publik në relizimin e programeve tona akademike lidhur me realizimin e praktikave mësimore për studentët.
- Mundësimi i shkëmbimit të eksperiencës në mësimdhënie të personelit akademik përmes shfrytëzimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për programet e mobiliteteve - International Credit Mobility Programs (Erasmus+ KA1) që Universiteti “Ismail Qemali” ka nënshkruar me Universitete prestigjioze në përputhje me kapacitetet pritëse mësimdhënëse, infrastrukturën në funksion të mësimdhënies, diversitetin kulturor dhe social.
- Vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie përmes pyetësorëve drejtuar studentëve, dhe mundësimi i rezultateve të pyetësorit personelit akademik.

Orientimi i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit drejt kërkimit shkencor është reflektuar në:

- punën kërkimore shkencore të personelit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencor në revista me faktor impakti, pjesëmarrjes përmes aplikimit apo implementimit të projekteve për vitin akademik 2022-2023.

### Departamenti i Ekonomiksit

Departamenti i Ekonomiksit, gjatë viti akademik 2022-2023, ka qënë i fokusuar në përmbushjen e misionit të tij pra “Edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të rinj me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e Ekonomiksit, të aftë për tu përballur me sfidat dhe nevojat e tregut të punës, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij”, si dhe i orientuar drejt rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, nxitjes së vullnetit të sipërmarrjes të studentëve dhe kontributit në komunitet.

### Departamenti i Biznesit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Departamenti i Biznesit gjatë viti akademik 2022-2023 ka qënë i fokusuar në përmbushjen e misionit të tij që është "Edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të rinj me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e biznesit, turizmit dhe marketingut, të aftë për tu përballur me sfidat dhe nevojat e tregut të punës, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vëndit nëpërmjet kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij", orientuar drejt rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, nxitjes së vullnetit të sipërmarrjes të studentëve dhe kontributit në komunitet.

Orientimi drejt rritjes së cilësisë në mësimdhënie është reflektuar në:

- Punën kërkimore shkencore të personelit akademik me kohë të plotë për marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademik (fakti që i gjithë personeli akademik i Departamentit të Biznesit i përket kategorisë profesor dhe lektor evidenton angazhimin serioz të personelit në përmbushjen e objektivave të arritjeve cilësore akademike),
- Rekrutimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me grada shkencore, tituj akademik dhe me eksperiencë në mësimdhënie.
- Pjesëmarrjes në mësimdhënie dhe leksione të hapura të personelit të ftuar me grada dhe tituj nga institucione të arsimit të lartë brënda dhe jashtë vëndit.
- Përdorimi i literaturës dhe teknikave bashkekohore dhe interaaktive në mësimdhënie.
- Krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me sektorin privat dhe publik në realizimin e programeve tona akademike lidhur me realizimin e praktikave mësimore për studentët.
- Mundësimi i shkëmbimit të eksperiencës në mësimdhënie të personelit akademik të ftuar nga Universitete të tjera Europiane, si dhe pjesëmarrja e studentëve të programeve mësimore të ofruara nga Departamenti i Biznesit, në mobilitete, përmes shfrytëzimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për programet e mobiliteteve - International Credit Mobility Programs (Erasmus+ KA1) që Universiteti Ismail Qemali ka nënshkruar me Universitete prestigjioze në përputhje me kapacitetet pritëse mësimdhënëse, infrastrukturën në funksion të mësimdhënies, mësimnxënies, diversitetin kulturor dhe social.
- Angazhimi i Departamentit të Biznesit në hapjen e programeve të reja mësimore në përputhje me nevojat e tregut të punës.
- Vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie përmes pyetsorëve drejtuar studenteve, dhe mundësimi i rezultateve të pyetsorit personelit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

**2. Qëllimet dhe objektivat e kërimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit**

- **Realizimi objektivave krahasuar me planin strategjik**
- **Strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse**

**Fakulteti i Shëndetit**

Në përfundim të vitit akademik 2022-2023, bilanci në lidhje me arritjet e objektivave në fushën e kërimit shkencor sipas Planit Strategjik të Fakultetit të Shëndetit është si vijon:

1. Përcaktimi i fushave prioritare të kërimit shkencor për çdo njësi bazë
  - Bazuar në Strategjinë e Kërimit Shkencor të FSH, për vitin akademik 2022-2023 janë përcaktuar fushat prioritare të kërimit shkencor për çdo njësi bazë.
2. Hartim projektsh kombëtare dhe ndërkombëtare
  - *Linja strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar*, të Planit Strategjik të UV nëpërmjet projektit Gold Health Care të realizuar nga Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik ka promovuar UV në nivel ndërkombëtar, por njëkohësisht edhe rritjen e kapaciteteve, falë shkëmbimit të informacionit dhe drejtimit të studimeve të përbashkëta me impakt për vendet bashkëpunuese dhe më gjerë. Në kuadër të projektit është nënshkruar edhe një marrëveshje ndërshtetërore që ndër të tjera synon në rritje të aksesit në të dhëna për kërkimin shkencor nga studiuesit e përfshirë në projekt.
  - *Partneritete të qëndrueshme* për aplikime projektsh ndërkombëtare në kuadër të programeve të financuara nga Komuniteti Evropian ku përshihen Programet ndërkufitare dhe transnacionale të kooperimit, Horizon 2020, Erasmus+, është një prioritet tjetër strategjik i vendosur. Në kuadër të kësaj është arritur aderimi në një konsorcium për të aplikuar me universitete prestigjioze Europiane në kuadër të thirrjes Erasmus + KA220.
  - Gjate vitit akademik 2022/2023 përfunduan me sukses dhe u hartuan raportet përfundimtare të 3 projekteve që Departamentet e Fakultetit të Shëndetit kanë fituar në thirrjet për “Projekte të Infrastrukturës së Kërimit Shkencor” (PIKSH), të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërimit Shkencor dhe Inovacionit 2022, 3 projekte ndërkombëtare përkatesisht ERASMUS +, European Union’s Horizon 2020 dhe 4 të tjera të financuara nga UV.
3. Integrimi i studenteve në kërkimin shkencor dhe inovacionin
  - *Linja strategjike Nr 3: Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombëtare*. Bazuar në këtë prioritet stafi i FSH ka pasur gjithmonë qëllim përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor. Në projektet dhe punimet kryera nga stafi i FSH për vitin akademik 2022-2023, kemi një përfshirje të gjerë të studenteve si pjesë e grupeve të punës apo supervizim të studimeve nga ana e stafit akademik. Këto punime u prezantuan edhe në Konferencën e II





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Studentore që u organizua nga DI në datën 5 Nëntor 2022, me temë: “Integrimi i evidencave të kërkimit shkencor në përmirësimin e kujdeseve infermierore”

### 4. Botimin e artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me bord editorial

- Gjate vitit akademik numerohen 42 *botime artikujsh* në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial të indeksuara në Pubmed, Thomson Reuters, Orcid etj me seli botimi në vendet e Bashkimit Europian (BE) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD), por edhe në revista shkencore kombëtare. Botimi i artikujve shkencore brenda vendit ka qënë kryesisht në Buletinën e Universitetit të Vlores i cili është një tregues për qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e këtij organi botues. Në të gjitha botimet evidentohet fryma e punës në grup jo vetëm në nivel departamenti, por edhe ndërfakultetore dhe në nivel ndërkombëtar. Duhet më shumë inkurajim i stafit për të nxitur botime në revista shkencore prestigjioze me faktor impakti.

### 5. Pjesëmarrjen në konferenca apo aktivitete të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

- Stafi akademik i FSH është prezantuar me punime në 68 *konferenca/aktivitete* shkencore (përfshirë dhe ato virtuale) të zhvilluara jashtë vendit, kryesisht në vendet e BE dhe Ballkanit Perëndimor si edhe të zhvilluara brenda vendit, kryesisht në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.
- Politikat stimuluese financiare për studentët dhe pedagogët e UV për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare kanë gjetur reflektim në rimbursim të shpenzimeve që kanë të bëjnë me tarifën e regjistrimit për pjesëmarrje. Ndërkohë që, shpenzimet në shkolla trajnuese apo vizita kërkimore janë mbuluar nga vetë programi apo projekti.

### 6. Organizimi i konferencave shkencore, simpoziumeve

- Këtë vit Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik të Fakultetit të Shëndetit organizoi Konferencën Ndërkombëtare 2023 me bashkëpunim të tre IAL-ve Shqiptare, Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë dhe me pjesëmarrje të lektorëve kyc të huaj, me reputacion shkencor të rëndësishëm. Kjo ishte e para konferencë e këtij lloji, organizuar në fushën e shëndetit. Gjithashtu në bashkëpunim, është organizuar një konferencë me koordinatort Universitetin e Elbasanit si dhe ëorkshop i dedikuar në konferencën ndërkombëtare të LUMEN INTERNATIONAL. Këto aktivitete shkencore kanë ndikuar jo vetëm në rritjen e vizualitetit të UV në arenën ndërkombëtare por i kanë dhënë stafit të qendrës dhe Fakultetit të Shëndetit mundësi për rritje profesionale por njëkohësisht të jenë faktor dhe konkurrues në arenën ndërkombëtare të kërkuesve në fushën e kujdesit shëndetësor dhe shëndetit publik.
- Departamenti i Kujdesit Shëndetësor ishte iniciator i realizimit të Simpoziumit Shkencor të realizuar në Qershor 2023 me temë: “Kërkimi Shkencor si orientues i politikave shëndetësore”. Qershor 2023 Vlorë. Simpoziumi shkencor ‘Kërkimi shkencor si orientues i Politikave Shëndetësore’ i organizuar nga DKSH, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti ‘Ismail Qemali’ Vlorë shërbeu si një nga mënyrat e promovimit të produkteve të arritura prej projekteve të kërkim-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

zhvillimit dhe infrastrukturës, të realizuara në kuadër të bashkëpunimit me Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

- Departamenti i Infermierisë organizoi më datën 5 Nëntor 2022, Konferenca e Dytë Studentore me temë: “Integrimi i evidencave të kërkimit shkencor në përmirësimin e kujdeseve infermiore II”. Në këtë konferencë u prezantuan punime kërkimore shkencore të studenteve kryesisht të nivelit Master i Shkencave në kuadër të mbrojtjes së diplomës të nivelit të dytë.
- 7. Organizimi i ditëve promociionale të shëndetit dhe shërbimet komunitare
  - Aktivitetet promociionale në Ditët Botërore të Shëndetit vazhdojnë të jenë një element i rëndësishëm i punës së stafit të FSH, të cilët në bashkëpunim me studentët, i kanë zhvilluar këto aktivitete në komunitet, me qëllim jo vetëm edukimin e komunitetit dhe të rinjve lidhur me problematikat shëndetësore të caktuara por edhe rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit.
- 8. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri është një prioritet tjetër që duhet të nxitet për realizim, nga ana e stafit për ndërmarrjen e projekteve të përbashkëta me impakt edukativ-social dhe ekonomik.

### Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

- të mundësojë dhe lehtësojë përfshirjen e stafit akademik dhe të studentëve në punë kërkimore
- të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal dhe kombëtar;
- të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tij;

Politikat e kërkimit shkencor kanë konsistuar në:

Mbështetja institucionale e stafit në lidhje me punën kërkimore ka konsistuar në:

- Trajtimin e vecantë të tyre për leje akademike, por trajtim financiar për pjesëmarrje në konferenca, ëorkshope, kongrese, si edhe për botime në revista brenda dhe jashtë vendit.
- Mbështetja për mobilitete të stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus+.
- Mbështetja e stafit akademik (në dy raste) të trajtuar vit sabbatik. Mbështetja e stafit akademik asistencë lektore në studimet doktrale jashtë vendit si në Departamentin e Biologjisë, Shkencë Kompjuterike, Shkencë Detare, Matematikë, por edhe të tjerë anëtarë të stafit akademik në studimet doktrale në universitetet brenda vendit
- Nxitja dhe motivimi i studentëve, kryesisht studentët e Masterit Shkencor në punë kërkimore shkencore në kuadër të përgatitjes së temave të diplomave, angazhimeve në ëorkshope,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

konferenca te organizuar nga njesite baze, fakulteti dhe Universiteti, botimi i punimeve te tyre ne Buletinin e Universitetit "Ismael Qemali"

### Fakulteti i Shkencave Humane

Veprimtaria kërkimore-shkencore në këtë fakultet është e lidhur ngushtë me fushat që mbulojnë programet e studimit që ofron fakulteti. Ato zhvillohen kryesisht në formën e aktiviteteve, ku bëjnë pjesë konferencat, seminarët, tryezat e rrumbullakëta, leksionet e hapura; produkteve kërkimore-shkencore, si artikujt shkencorë, monografi, përmbledhje aktesh të konferencave, përmbledhje artikujsh, buletine, rezultate të punës shkencore (raporte); dhe hulumtimeve si gjermime, inspektive në terren, kërkime në arkivë dhe fonde shkencore, projekte kërkimore.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në fakultet organizohet nga të katër njësitë e saj, si dhe nga QSAB (Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike), e cila luan një rol të veçantë për kërkimin shkencor në fakultet.

Konkretisht, gjatë vitit akademik 2022-2023 në përputhje me planin strategjik janë realizuar:

- Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor dhe inovacionin

Me qëllim nxitjen e integritetit të studentëve në kërkim shkencor dhe inovacion njësitë bazë të FSHH kanë organizuar aktivitete të ndryshme si, ëorëshope, leksione të hapura, konkurse, dhe ekspozita me pjesëmarrjen aktive të studentëve. Gjithashtu, në funksion të rritjes së kontaktit dhe integritetit të studentëve në kërkim shkencor, është inkurajuar pjesëmarrja e tyre si dëgjues në konferencat/aktivitetet shkencore të organizuara nga njësitë bazë/FSHH, si edhe përfshirja e një pjese prej tyre edhe si mbështetës në procesin e organizimit të aktiviteteve shkencore, krahë stafit akademik të FSHH.

- Pjesëmarrja në konferenca apo aktivitete të tjera shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Gjatë vitit akademik 2022-2023 stafi akademik i FSHH ka qenë i angazhuar me pjesëmarrjen e tij në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, seminare, trajnime, workshop-e. Veprimtaria kërkimore-shkencore nuk shtrihet vetëm në planin individual, por edhe në grup, gjë e cila dëshmohet nga numri i lartë i workshop-eve të organizuara nga stafi akademik me studentët e të katër njësive bazë të FSHH.

Nga stafi i FSHH janë realizuar në total 137 prezantime në konferenca/aktivitete shkencore ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit.

- Botimi i artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me bord editorial

Gjatë këtij viti, stafi akademik i FSHH ka realizuar në total 85 botime artikujsh në revista shkencore me bord editorial, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe 8 botime tekstesh. Numërohen 31 artikuj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

shkencorë të botuar nga stafi i DGjH në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të indeksuara, si edhe 2 tekste të botuara. Numërohen 28 artikuj shkencorë të botuar nga stafi i DGjL përgjatë këtij viti, nderkohe që 4 artikuj janë në proces botimi; 20 nga stafi i DE; dhe 6 artikuj shkencore dhe 2 tekste të botuara nga stafi i DD (shih tabelën përmbledhese të artikujve).

- Organizimi i aktiviteteve shkencore/konferencave ndërkombëtare

Gjatë këtij viti FSHH ka qenë organizator i disa konferencave ndërkombëtarë në fusha të ndryshme studimi që mbulohen nga njësitë bazë të FSHH. Këto aktivitete kanë qenë në funksion të nxitjes së kërkimit shkencor, bashkëpunimit dhe partneritetit të njërive bazë të FSHH mes tyre, nxitjes së bashkëpunimit dhe partneritetit të FSHH me universitete të tjera, si edhe rritjes së vizibilitetit të FSHH.

-Departamenti i Gjuhëve të Huaja ka qenë organizator i 3 konferencave ndërkombëtare, një prej të cilave është organizuar në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë. Kështu, më 16.12.2023 është organizuar Konferenca e shtatë ndërkombëtare, "Intercultural Dimension in Multidisciplinary Studies". Me 03.02.2023 është organizuar Konferenca e dytë ndërkombëtare, "The languages of the Balkans in the integration context", pjesë e aktiviteteve në kuadër të projektit të financuar nga BE, Jean Monnet Module "Foreign Language Teaching in and for European Contexts/FoLATE". Ky aktivitet është realizuar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja në funksion të nxitjes së kërkimit shkencor përmes projekteve kërkimore dhe në mbështetje të programit të ciklit të trete "Doktorate" në FSHH. Me 30 qershor 2023 është realizuar konferenca ndërkombëtare "Shqipëria në shkrimet e udhëtimit të periudhës paskomuniste (1990 - ) Albania in post-communist Travel Writing (1990 - )", financuar nga AKKSHI në kuadër të projektit me të njëjtin titull, si një bashkëpunim mes Departamentit të Gjuhëve të Huaja dhe atij të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë. Ky aktivitet është realizuar në funksion të nxitjes së kërkimit shkencor përmes projekteve kërkimore dhe në mbështetje të programit të ciklit të trete "Doktorate" në FSHH. Gjithashtu, janë organizuar dy seminare shkencore në kuadër të konferencës së 16 të ESSE-s (European Society for the Study of English), që u mbajt në Mainz, Gjermani, në datat 29 gusht-2 shtator 2022: seminari 19 "Global Implications of News Discourse Published in English in the Social Media" (i hartuar nga prof. as. Jasmina Đorđević, Universiteti i Nishit, Serbi dhe prof. as. Bledar Toska, DGJH, UV) dhe seminari 24 "Lockdown Literature: Past and Present Pandemic Paradigms" (i hartuar nga prof. as. Armela Panajoti, DGJH, UV dhe Dr. Angelika Reichmann, Universiteti Katolik Eszterhazy, Eger, Hungari).

- Departamenti i Edukimit ka organizuar Konferencën e dytë Ndërkombëtare mbi Shkencat Humane dhe Edukimin. Ky aktivitet, vec nxitjes së kërkimit shkencor në DE ka synuar edhe nxitjen e partneritetit me universitete italiane.

- Në funksion të nxitjes së kërkimit në DD dhe rritjes së partneritetit me universitetet italiane është organizuar nga DD, International Scientific Conference, 1st edition "Rolando Quadri - relectures in international laë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

-Nxitja e bashkëpunimit dhe partneritetit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në kuadër të nxitjes së bashkëpunimit dhe partneritetit me institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, FSHH apo njësitë bazë të tij, kanë qenë bashkëpunëtorë në organizimin e 8 konferencave/aktiviteteve shkencore të realizuara nga institucione të tjera. FSHH/Njësitë bazë të FSHH kanë bashkëpunuar me Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan; Akademinë e Studimeve Albanologjike; Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës; Institute of English Language and American Studies, State University of Tetovo; Fakultetin e Filologjisë, Universiteti "Fehmi Agani", Gjakovë; Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

- Rritja e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në nivel lokal dhe rajonal

Në funksion të rritjes së bashkëpunimit në nivel lokal dhe rajonal, QSAB në bashkëpunim me DGJL dhe Bibliotekën e UV-se ka organizuar 18 aktivitete promovuese përgjatë këtij viti. Këto aktivitete kanë pasur për qëllim promovimin e figurave historike të qytetit të Vlorës, promovimin e shkrimtarëve, publicistëve dhe studiuesve vlonjatë, si edhe promovimin dhe mbështetjen e krijuesve të rinj.

### Fakulteti i Ekonomisë

#### Departamenti Ekonomiksit

*Qëllimi dhe objektivi i kerkimit shkencor i Departamentit të Ekonomiksit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Ekonomiksit dhe misionit të UV të miratuara në Planin Strategjik të Departamentit sipas sv cilit:*

- Departamenti i Ekonomiksit ka për mision kryesor "sigurimin e një kërkimi shkencor dhe edukimi në shkencat ekonomike të një cilësie të lartë". Kjo kërkon një orientim drejt publikimeve dhe kërkime të njohura në vend dhe më gjerë, duke garantuar "promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit", gjë që rrit të kuptuarin e fenomeneve ekonomike në atë mënyrë që lejon çdokënd të mirëinformohet mbi debatet e ditës për politikën e volitshme për zhvillim.
- Departamentit të Ekonomiksit ka gjithashtu për mision "të sigurojë njohuri të vazhdueshme, bashkëkohore dhe të thella të studentëve në degën e ekonomiksit, të përshtatshme me traditat shqiptare, standardet europiane dhe kërkesat e grupeve të interesit rajonal duke luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë."

*Politikat e kerkimit shkencor janë të orientuara në:*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Angazhimin dhe përfshirje e stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore ndërkombëtare përmes ofrimit të mbështetjes financiare nga UV. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë dy herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto aktivitete
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore në nivel fakulteti me të gjithë pedagogët e Departamentit të Ekonomiksit.
- Rritje e numrit të botimeve të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Mbështetjen dhe zhvillimin e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe ëorkshop-eve në nivele departamenti dhe fakulteti si dhe bashkëpunim për organizimin e konferencave ndërkombëtare në partneritet me universitete prestigjioze Europiane.
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik, student dhe komuniteti Ekonomiksit nëpërmjet takimeve, seminare, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Organizim e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

### Departamenti i Biznesit

Qëllimi dhe objektivi i kerkimit shkencor të Departamentit të Biznesit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Biznesit dhe misionit të UV.  
Objektivat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

- Angazhimin dhe përfshirjen e stafit akademik në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore me të gjithë pedagogët e departamentit të Biznesit.
- Rritja e numrit të projekteve kërkimore konkurruese (në bashkëpunim me departamentet e tjera);
- Rritje e numrit të botimeve, të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson Reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik- student dhe komunitetit të biznesit nëpërmjet takimeve, seminareve, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Krijimi i një sistemi që inkurajon kërkimin shkencor cilësor duke përdorur dhe aplikuar incentiva që stimulojnë dhe vlerësojnë publikimet më cilësore të stafit akademik dhe duhet të synojë rritjen e bashkëpunimit shkencor të stafit të fakultetit me kërkues të huaj.
- Organizimin e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

### *Organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në departament*

Punën kërkimore shkencore të personelit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencor në revista me faktor impakti, pjesëmarrjes përmes aplikimit, apo implementimit të projekteve për vitin akademik 2022 – 2023

### *Politikat e kërkimit shkencor*

Politikat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

- Angazhimin dhe përfshirje të stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore ndërkombëtare përmes ofrimit të mbështetjes financiare nga UV. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë dy herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto aktivitete
- Angazhimi i stafit akademik të Departamentit të Biznesit në hartim dhe zbatim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në nivel Universiteti.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore në nivel fakulteti me të gjithë pedagogët e departamentit të Biznesit.
- Rritje e numrit të botimeve të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Mbështetjen dhe zhvillimin e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe ëorkshop-eve në nivele departamenti dhe fakulteti si dhe bashkëpunim për organizimin e konferencave ndërkombëtare në partneritet me universitete prestigjioze Europiane.
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik, student dhe komuniteti biznesit nëpërmjet takimeve, seminare, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit

Qëllimi dhe objektivi i kërkimit shkencor të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe misionit të UV-së. Politikat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Angazhim dhe përfshirje e stafit akademik në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore me të gjithë pedagogët e departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.
- Rritja e numrit të projekteve kërkimore konkurruese (në bashkëpunim me departamentet e tjera);
- Rritje e numrit të botimeve, të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson Reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik- student dhe komunitetit të biznesit nëpërmjet takimeve, seminareve, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Krijimi i një sistemi që inkurajon kërkimin shkencor cilësor duke përdorur dhe aplikuar incentiva që stimulojnë dhe vlerësojnë publikimet më cilësore të stafit akademik dhe duhet të synojë rritjen e bashkëpunimit shkencor të stafit të fakultetit me kërkues të huaj.
- Organizimin e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

### **3. Te dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.**

#### **Fakulteti i Shëndetit**

##### **Vlerësim i përgjithshëm**

Gjatë vitit akademik 2022-2023 Fakulteti i Shëndetit ka vazhduar me sukses veprimtarinë e tij në të gjitha funksionet e veta: veprimtarinë akademike, aktivitetin shkencor dhe shërbimet komunitare. Ky ka qenë një vit mëse i suksesshëm për stafin tonë akademik në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve trajnuese dhe promovionale.

##### **Veprimtaria organizative**

Struktura, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i Fakultetit të Shëndetit përcaktohen në statutin dhe rregulloren e Universitetit 'Ismail Qemali' Vlorë dhe në rregulloren e FSH. Pranë Departamentit të Infermierisë dhe Kujdesit Shëndetësor funksionon Zyra e Këshilltarit Akademik, që është një strukturë për orientimin dhe këshillimin e studentëve nga regjistrimi në programin mësimor deri në marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit. Këshilltari akademik emërohet çdo fillim viti akademik. Gjithashtu kemi dhe koordinatorët e praktikave për dy rrethet ku realizohet praktika mesimore dhe ajo profesionale: Fier dhe Vlorë (spitalet Rajonale të Vlorës dhe të Fierit, Spitali Memorial Fier) të cilët





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

koordinojnë praktikat mësimore dhe ato profesionale me dy spitalet ku realizohet kjo praktikë në programet Bachelordhe Master.

Veprimtaria akademike

Gjatë sezonit vjeshte 2022 dhe Pranvere 2023, mësimdhënia u realizua në auditoret e Fakultetit të Shëndetit dhe institucioneve shëndetësore në mënyrë normale. Të gjithë modulet sipas semestrave akademikë të parashikuara në planet mësimore janë ofruar në mënyrë të plotë.

Gjatë periudhës Tetor 2022 - Tetor 2023 u zhvilluan sezonet: Vjeshtë 2022, Pranverë 2023, Riprovime Janar 2023, Riprovimet Shtator 2023 për 2 programe mësimore të ciklit të parë të studimeve:

- Bcs në Infermieri të Përgjithshme
- Bcs në Mami Infermieri

dhe 4 programe mësimore të ciklit të dytë të studimeve:

- MS në Shkenca Infermierore
- MP në Infermieri Patologjike
- MP në Infermieri Kirurgjikale
- MP në Infermieri Pediatrike

Veprimtaria kerkimore shkencore

Analiza e Kërkimit Shkencor për vitin akademik 2022-2023 të Fakultetit të Shëndetit u bazua në veprimtarinë kërkimore shkencore të 2 njësive bazë (departamenteve) - Departamentit të Infermierisë dhe Departamentit të Kujdesit Shëndetësor si dhe të qendrës kërkimore shkencore - Qendrës Studimore për Shëndetin Publik, e cila luan njëkohësisht dhe rolin e njësive bazë. Ajo është hartuar në mbështetje të Planit Strategjik 2018-2024 të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, vendim Nr.26, datë 08.11.2018, Linja Strategjike Nr.3 për Kërkim Shkencor sipas Standarteve Ndërkombëtare si edhe në Strategjinë e Kërkimit-Shkencor të Fakultetit të Shëndetit

### Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore

FSHTN zhvillon mesimin në Godinen C, për të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Mjediset janë të mjaftueshme dhe plotësojnë standartet akademike siç edhe është komunikuar nga MAS në kontrollin e standarteve. Në fillim të vitit akademik nga FSHTN është bërë traditë orjentimi dhe njohja e studenteve me programet dhe njësitet përkatëse nga Këshilltaret akademik. Njohja me mjediset, sallat e leksioneve dhe të seminareve, mjediset laboratorike, mjediset e qendrës kërkimore shkencore etj. Mësimdhënia në FSHTN vlerësohet maksimalisht në të gjithë shtrirjen e kalendarit akademik. Ka një monitorim të vijueshëm të procesit të mësimdhënies, orarit, frekuentimit të studenteve, prej dekanatit dhe departamentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Vleresohet se studentet janë të orjntuar në përdorimin e sistemit elektronik, regjistrimet, detyrimet akademike etj.

Kërkimi shkencor është zhvilluar në mënyrë individuale dhe të grupuar. Individualisht stafi akademik ka qenë pjesë e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, boitme në revista brenda dhe jashtë vendit, në shumë raste edhe duke u mbështetur financiarisht sipas kritereve të vendosura në mënyrë institucionale.

Gjithashtu pjesëmarrja në projekte ka qenë formë tjetër e kërkimit shkencor. Përmes kësaj në FSHTN stafi akademik ka qenë pjesëmarrës në kërkim, por përmes tyre janë siuruar baze materiale, mjete dhe laboratore në dispozicion të Fakultetit (Biologji, Shkenca detare, QKSH). Në qendrën kërkimore shkencore të FSHTN është krijuar një bazë e mirë materiale në funksion të kërkimit shkencor. Këto janë në dispozicion jo vetëm të stafit por edhe të studentëve të MS, një pjesë të punës së tyre analizave kimiko fizike, matjeve etj. i kryejnë në ekto mjedise.

### Fakulteti i Shkencave Humane

Kërkimi shkencor në FSHH organizohet në përputhje me zhvillimet në drejtimin e gjerë të shkencave humane, dhe më ngushtë, të atyre sociale, juridike, filologjike dhe të edukimit.

Veprimtaritë kryesore të kërkimit realizohen në disiplinat kryesore që mbulon fakulteti, në kuptimin e atyre që mbulohen në programet e studimit dhe në ato fusha ku është i specializuar stafi i fakultetit dhe në lidhje me natyrën e programit të studimit. Veprimtaria shkencore është realizuar nga katër departamentet e FSHH dhe Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike (QSAB). Të katër departamentet e FSHH kanë prioritet integrimin e kërkimit shkencor në procesin e mësimdhënies.

Janë realizuar workshop-e dhe seminare me tematika të ndryshme ku janë përfshirë edhe studentë, kryesisht nga Departamenti i Edukimit dhe ai i Drejtësisë. Personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme në fushat respektive të kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies, kryesisht përmes pjesëmarrjes së stafit në projekte, seminare, trajnime, workshop-e, konferenca shkencore, etj. Numri i kënaqshëm i artikujve shkencorë të botuar në revista të huaja prestigjioze, si edhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare të organizuara brenda dhe jashtë vendit, angazhimi në projekte kërkimore janë tregues sinjifikativë në këtë drejtim. Kualifikimi i stafit ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

Për sa i përket formave të zhvillimit të kërkimit shkencor në të katër njësitë e FSHH-së, ai ka formë dhe natyrë të ndryshme. Në thelb mbetet kërkimi dhe avancimi akademik, kryesisht me natyrë individuale, gjë që e bën një pjesë të stafit më aktive se pjesa tjetër në angazhime me natyrë kërkimore, dukuri që duket se shpjegohet, përpos profilit akademik dhe karakteristikave individuale, edhe me motivimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

personal për të avancuar, mundësitë reale për kërkim në fusha specifike, por edhe me atë se sa kompakte dhe efiente janë grupet mësimore me karakter kërkimor-shkencor brenda njësive bazë. Duket se në disa raste ato funksionojnë më mirë në disa njësi se sa në të tjera. Për shembull, në Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, ky konceptim disiplinor (gjuhësi, letërsi) ka qenë më i hershëm dhe më i spikatur. Kurse në Departamentin e Gjuhëve të Huaja një tregues që flet pozitivisht për funksionimin e tyre është vijimi i traditës së organizimit të konferencës vjetore nga DGJH, ku çdo vit puna për organizimin e këtij aktiviteti merret përsipër nga një grup i ndryshëm kërkimor, duke ndjekur një lloj radhe, por edhe vijimësie në funksion të vazhdimit të traditës së krijuar. Logjika e grupimit të ngushtë disiplinor të personelit ka kontribuar në krijimin e individualitet dhe profilit disiplinor të anëtarëve të personelit gjë që duhet në numrin e botimeve dhe referimeve të realizuara nga stafi i DGJH-së apo në faktin që stafi i këtij departamenti ka në përbërje të tij një nga stafet më të kualifikuara në FSHH.

Në Departamentin e Edukimit kërkimi shkencor ka qenë përparësi kryesisht me natyrë individuale, ndoshta si nevojë e lektorëve për të krijuar së pari identitet individual, profil kërkimor në një disiplinë të dhënë. Ky proces po mbyllet dhe departamenti është në gjendje të zhvillohet në të dy përbërësit, si në atë individual, edhe në atë të profilit si grup kërkimor me identitet të qartë. Numri i botimeve dhe kumtesave është tregues i punës serioze të secilit prej anëtarëve të departamentit. Në Departamentin e Drejtësisë, veprimtaria kërkimore-shkencore nuk shtrihet vetëm në planin individual, por edhe në grup, gjë e cila dëshmohet nga numri i lartë i ëorkshop-eve të organizuara nga stafi akademik me studentët e Departamentit të Drejtësisë.

Nga ana tjetër vihet re një individualitet kolektiv, në kuptimin që ndonjë njësi bazë është më aktive në tërësi se të tjerat, gjë që duket në raportimet e mësipërme (aktivitete të organizuara si njësi, numri i artikujve apo botimeve shkencore, numri i referimeve, numri i stafit të kualifikuar me tituj akademikë). Për t'u theksuar është fakti se për 2022-2023, të katër njësitë bazë janë impenjuar të organizojnë aktivitete shkencore në nivel njësie bazë të llojit konferencë, por edhe në bashkëpunim (Shih tabelën përmbledhëse). Përveç tyre, të larmishme kanë qenë edhe seminarët dhe workshop-et (Tabela përmbledhëse).

Këtë vit akademik, personeli akademik ka qenë edhe më i angazhuar në shkëmbime akademike për mësimdhënie/trajnim dhe shkëmbim ekperiencash, kryesisht në kuadër të programit "Erasmus+", ku për vitin akademik 2022-2023 është vërejtur rritje e numrit të anëtarëve pjesëmarrës.

Cilësia e veprimarisë kërkimore është e dukshme edhe tek niveli i botimeve, në mënyrë të posacme të artikujve, ku një numër i madh i tyre janë në revista shkencore të indeksuara në databaza të njohura si SCOPUS, CEEOL, EBSCO, MLA etj. Krahasuar me vitin e kaluar është shtuar edhe numri i botimeve (tekste) në trajtën e monografive, vëllimeve përmbledhëse, madje edhe enciklopedi.

Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor është modeste. Ka nevojë për pajisje me softe për zhvillimin e kërkimit në laborator dhe kthimin e tyre në laboratorë për qëllime jo vetëm didaktike, si për shembull pasurimin me softe për kryerjen e analizave statistikore të korpuseve gjuhësore.

Pjesë e infrastrukturës në dispozicion është edhe biblioteka ku sigurohet literaturë bazë dhe ndihmëse në formën fizike të teksteve mësimore, shkencore dhe buletinëve. Pranë bibliotekës qendrore të UV-së ka një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit, hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor, si dhe tekst mësimor në formë elektronike në gjuhë të huaj. Përveç Bibliotekës së UV-së dhe të FSHH-së, studentët e programeve në gjuhë të huaj kanë mundësinë të shfrytëzojnë edhe Këndin e Leximit të DGJH-së, i cili ka një fond të pasur tekstesh në gjuhë italiane dhe angleze, sidomos në/për letërsinë italiane, angleze dhe amerikane, por edhe atë botërore të përkthyer në italisht, trashëgimi nga ish Spazio Culturale Italiano.

Infrastrukturës në FSHH i është shtuar edhe laborator i përkthim-interpretimit.

### Fakulteti i Ekonomisë

Qëllimi dhe objektivi i kërkimit shkencor të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit dhe misionit të UV-së. Politikat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

- Angazhim dhe përfshirje e stafit akademik në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore me të gjithë pedagogët e departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.
- Rritja e numrit të projekteve kërkimore konkurruese (në bashkëpunim me departamentet e tjera);
- Rritje e numrit të botimeve, të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson Reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik- student dhe komunitetit të biznesit nëpërmjet takimeve, seminareve, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Krijimi i një sistemi që inkurajon kërkimin shkencor cilësor duke përdorur dhe aplikuar incentiva që stimulojnë dhe vlerësojnë publikimet më cilësore të stafit akademik dhe duhet të synojë rritjen e bashkëpunimit shkencor të stafit të fakultetit me kërkues të huaj.
- Organizimin e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Departamenti i Biznesit është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë që zhvillon veprimtari mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore në fushën e ekonomisë.

Për mbarrëvajtjen e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore-shkencore, Departamenti i Biznesit është i organizuar në dy grupe mësimore me karakter mësimor-kërkimor, të cilat janë mini-struktura që kryejnë veprimtari akademike vetëm brenda departamentit, në funksion dhe në varësi të tij:

1. Grupi mësimor -kërkimor i Biznesit
2. Grupi mësimor kërkimor i Marketing Turizmit

Departamenti i Biznesit aktualisht ka 14 (katërmëdhjetë) staf akademik me kohë të plotë, nga të cilët 5 (pesë) mbajnë titullin Profesor i Asociuar, dhe 9(nëntë) mbajnë gradën Doktor Shkencash në Ekonomi. Departamenti i Biznesit fton staf akademik të kategorisë profesorë për një mësimdhënie cilësore në të tre degët që mbulon (biznes, marketing, turizëm). Departamenti ka 1 (Një) staf ndihmës akademik në sekretarinë mësimore dhe një laborante të fakultetit pranë laboratorit.

Departamenti i Ekonomiksit, gjatë viti akademik 2022-2023, ka qënë i fokusuar në përmbushjen e misionit të tij pra *“Edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të rinj me konceptet bazë teorike dhe praktike në fushën e Ekonomiksit, të aftë për tu përballur me sfidat dhe nevojat e tregut të punës, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik e social të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij”*, si dhe i orientuar drejt rritjes së cilësisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, nxitjes së vullnetit të sipërmarrjes të studentëve dhe kontributit në komunitet.

*Qëllimi dhe objektivi i kerkimit shkencor i Departamentit të Ekonomiksit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Ekonomiksit dhe misionit të UV të miratuara në Planin Strategjik të Departamentit sipas sv cilit:*

- ❖ Departamenti i Ekonomiksit ka për mision kryesor *“sigurimin e një kërkimi shkencor dhe edukimi në shkencat ekonomike të një cilësie të lartë”*. Kjo kërkon një orientim drejt publikimeve dhe kërkime të njohura në vend dhe më gjerë, duke garantuar *“promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit”*, gjë që rrit të kuptuarin e fenomeneve ekonomike në atë mënyrë që lejon çdokënd të mirëinformohet mbi debatet e ditës për politikatat e volitshme për zhvillim.
- ❖ Departamentit të Ekonomiksit ka gjithashtu për mision *“të sigurojë njohuri të vazhdueshme, bashkëkohore dhe të thella të studentëve në degën e ekonomiksit, të përshtatshme me traditat shqiptare, standardet europiane dhe kërkesat e grupeve të interesit rajonal duke luajtur një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë.”*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

### Sektori i Sigurimit të cilësisë NJSBCVI

Qasja e sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohet tek rezultatet dhe proceset e synuara për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe arritjen e rezultateve të synuara të të nxënit.

NJSBCVI në lidhje me raportimin e cilësisë së mësimdhënies ka implementuar instrumenta të ndryshëm për vlerësimin e cilësisë si, pyetësorë, takime me fokus-grupe si dhe ëorkshop gjatë vitit akademik 2022-2023 si më poshtë të detajuara:

- Një nga detyrat kryesore të NJSBCVI-së, të parashikuar në ligjin e arsimit të lartë 80/15 si dhe në aktet e brendshme të UV-së (Statut dhe Rregullore), si dhe me Vendimin Nr. 24 të Senatit Akademik të datës 21.05.202018, është realizimi i pyetësorit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi të ofruar në UV. NJSBCVI-ja ka përfunduar përpunimin e të dhënave të pyetësorëve të plotësuar prej studentëve për vitin akademik 2022-2023. Numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve në programet e Ciklit të Parë të Studimeve për vitin akademik 2022-2023 është 11256 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë) pyetësorë, si dhe numri i programeve të vlerësuara prej studentëve është 29 (njëzet e nëntë) programe Bachelor. Numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve në programet e Ciklit të Dytë të Studimeve është 5726 (pesë mijë e e shtatëqind e njëzet e gjashtë) pyetësorë si dhe numri i programeve të vlerësuar prej studentëve është 31 (tridhjetë e një) programe MP dhe MS, si dhe së fundi numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve të regjistruar në programin e studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi është 504 (pesëqind e katër) pyetësorë.
- Workshop me temë “Optimizimi i programeve të studimit të mësuesisë. Sfidat për një edukim cilësor afatgjatë”, I miratuar nga Rektori me shkresë Nr. 419 Prot, datë 24.02.2023. Në seksionin e dedikuar për diskutime dhe rekomandime të pranishmit krahas vlerësimit dhe nevojës për shpeshimin e organizimit të aktiviteteve të tilla dhanë disa rekomandime për përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar tek nevojat aktuale për përgatitjen adekuate të mësuesve.
- Organizimi i fokus grupeve si pjesë e politikave të UV-së për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, vjen si mekanizëm në kuadër të diversifikimit të instrumentave për vlerësimin e programeve të studimit, e merituar me Vendim Rektorati Nr.6, dt. 27.05.2022 i risaktësuar. Objektivat e organizimit të fokus-grupeve ishin përcjellja e zërit dhe përvojës së studentëve në prag diplomimi në diskutimet e strukturave vendimarrëse; evidentimi i arritjeve dhe dobësive të programit të studimit, motivimi i praktikave dhe arritjeve me qëllim hartimin e mëtejshëm të planit të masave për përmirësimin e tyre. Gjatë muajit shkurt janë organizuar 3 (tre) takime fokus-grupe me studentë në prag diplomimi të programeve Master Shkencor dhe Master Profesional përkatësisht:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

1. MS në "Financë",
2. MS në "Pasuri e Paluajtshme"
3. MS në "Administrim Biznesi"
4. MP në "Mësuesi për CLAB në Gjuhën Angleze"
5. MP në "Mësuesi për CLAB në Gjuhën Italiane"
6. MS në "Përkthim dhe Interpretim"
7. MS në "Edukim"
8. MS në "Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërisë"
9. MS në "Pedagogji e Specializuar Sociale"

Gjatë muajit prill 4 (katër) takime fokus-grupe:

1. MS në "Biologji Mjedisore"
2. MP në "Mësuesi për AM në Biologji me profil Minor në Kimi"
3. MS në "Shkenca Kompjuterike"
4. MP në "Mësuesi për AM në lëndën Informatikë"
5. MP në "Matematikë"
6. MP në "Histori-Gjeografi"
7. MS në "Drejtësi" (programi 5-vjeçar)
8. MS në "Marrëdhënie Ndërkombëtare".

Gjatë muajit maj 5 (pesë) takime fokus grupe:

1. MS në "Shkenca Infermierore"
2. MP në "Marketing"
3. MP në "Sipërmarrje në Turizëm"
4. MP në "Financë"
5. MP në "Kontabilitet"
6. MP në "Sipërmarrje në Ekonomiks"
7. MP në "Shkenca Administrative"
8. MP në "E Drejtë Penale"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

9. MP në "Administrim Publik"
  10. MP në "Infermier Patolog"
  11. MP në "Infermieri Kirurgjikale"
  12. MP në "Infermieri Pediatrike"
  13. MP në "Studime të Avancuara Detare"
  14. MP në "Operacione Industriale dhe Navale"
- Vendim Senati nr. 13, date 06.05.2021, Rekomandimi nr. 7, objekti specifik nr. 3: "Përmirësimi I programeve të studimit nëpërmjet vlerësimit të ALUMNI (organizimi I pyetësorit për ALUMNI-n). Për implementimin dhe hartimin e pyetësorit ALUMNI, për vlerësimin e programeve të studimit, grupi I punës është duke hulumtuar për përmbushjen e standardeve dhe realizimin e pyetësorit i cili do të ndikojë në forcimin e marrëdhënieve midis institucionit dhe studentëve të diplomuar. Qëllimi i aplikimit të këtij instrumenti të ri vlerësimi është përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së programeve të studimit në kuadër të filozofisë së vlerësimit 360°.

### 4. Fusha Mësimdhënia

#### Fakulteti i Shëndetit

Në lidhje me proceset që lidhen me mësimdhënien, stafi i Fakultetit të Shëndetit i ka realizuar objektivat sipas planit strategjik:

- Në hartimin dhe dorëzimin në afat të *marrëveshjes së orëve të punës* të planifikuara dhe të realizuara.
- Angazhimin aktiv në *plotësimin e pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies* nga ana e studentëve.
- Rishikimin, përmirësimin, miratimin dhe dorëzimin brenda afateve të kërkuara të syllabuseve të lëndëve nga titullari.
- Përgatitjen dhe miratimin e teksteve mësimore që do të përdoren si literaturë bazë duke ndjekur normativën e Fakultetit të Shëndetit dhe UV.
- Përgatitjen e syllabuseve të lëndëve në gjuhë të huaj, të dorëzuara në departamentin përkatës, ku ofrohet programi i studimit ku moduli bën pjesë.
- Miratimi dhe nënshkrimi paraprak i tezave të provimeve nga titullari i lëndës dhe drejtuesi i departamentit nga të gjithë lektorët e stafit akademik të FSH. Provimet vlerësuese (paraprovimet dhe provimet finale) u zhvilluan normalisht, në afat dhe pa probleme. Paraprovimet dhe provimet finale janë zhvilluar në oraret e paracaktuara (të publikuara që 2-3 javë më parë për studentët) dhe procesi i ankimimit është zhvilluar normalisht. Vlerësimi i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

njohurive për lëndët përkatëse u zhvillua me atë të provimeve me shkrim të realizuara në auditoret e FSH. Gjatë semestrit Pranverë 2023 pedagogia Mimoza Çanga ka realizuar vlerësimin e studentëve në lëndën e INF 132 duke përdorur projektin CleanScore për vlerësimin elektronik të studentëve.

- Funksionimi me shumë efikasitet i *Këshilltarit Akademik* për çdo departament, duke i legjitimuar gjithë bazën e nevojshme të funksionimit dhe detyrave në Rregulloret e departamenteve përkatëse. Këshilltarët akademikë hartuan për studentët e vitit të parë Udhëzues për programet akademike dhe funksionimin e jetës studentore. U zhvillua një punë e gjerë dhe intensive në sekretari dhe rrjetet sociale (faqen e facebook të FSH) për informimin e studentëve të saporregjistruar. Po kështu u ngritën grupe tutoriati nga studentët e viteve më larta.
- Organizimin e praktikave spitalore dhe bashkërendimin e punës me personelin shëndetësor në spitale nga *Koordinatorët e Praktikave*. Ka qenë puna e tyre e jashtëzakonshme, që kanë programuar çdo orë individuale të studentëve duke bërë të mundur realizimin me sukses të praktikave klinike në Spitalet Rajonale. Labororet e lëndëve INF 162 dhe INF 132 janë realizuar në grupe me jo më shumë se 12-13 studentë. Praktikantët mësimorë janë organizuar nga pedagogët e praktikave duke mos patur më shumë se 20 studentë në repartet përkatëse
- Koordinimi midis orëve teorike të realizuara në auditoret e FSH dhe UV (leksione & laboratore) dhe orëve të praktikave mësimore ka qenë i kënaqshëm.
- Perpara sezonit të provimeve, Pranverë 2023 u organizuan *orë konsultuese* për studentët e vitit të tretë përpara provimit të diplomës.
- Për të gjitha modulet e ciklit Bachelor dhe për mbi 50% të moduleve të ciklit Master ka *literaturë bazë* të konsoliduar në dispozicion të studentëve, pjesërisht të marra nga fakultetet e Tiranës, pjesërisht cikle leksionesh të përkthyer nga pedagogët tanë. Kemi nevojë të mëdha në sigurimin e literaturës profesionale bashkëkohore. Edhe këtë vit kemi bërë kërkesën e përsëritur për literaturë profesionale, por ende biblioteka universitare disponon vetëm literaturë të outdate-uar. Ndërkohë krijimi i mundësisë për përdorimin e U-Library, rrit mundësinë për kërkim shkencor dhe aplikim të të rejave shkencore si nga stafi akademik ashtu dhe nga studentët e departamentit tonë.
- Nuk janë konstatuar shkelje të disiplinës në punë nga ana e stafit. Provimet janë zhvilluar sipas orareve të parashikuara paraprakisht, pa probleme disiplinore. Ankimimet kanë qenë të pakta dhe studentëve në çdo rast u është siguruar transparencë e plotë e vlerësimeve të tyre prej pedagogëve që kanë realizuar vlerësimet. Një ankesë e bërë prej studentëve të vitit të parë për pedagogen Prof. Asoc Mimoza Çanga, në lëndën INF 132, u vu në dijeni dekani i fakultetit dhe në bashkëpunim me dekanen dhe pedagogen në fjalë u mundësua zgjidhja e kërkesave të studentëve .
- Rreth 84% e studentëve Bachelor në FSH janë diplomuar brenda kohës së rregullt akademike. 77% e studentëve Master janë diplomuar brenda kohës së rregullt akademike
- Nuk kemi patur probleme me menaxhimin financiar të tarifave akademike. Pagesat nga ana e studentëve të të dyja cikleve të studimit për vitin akademik që sapo u mbyll janë shlyer 100%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Kemi patur bashkëpunim shumë të mirë me Spitalin Rajonal të Vlorës dhe Fierit për zhvillimin e praktikave mësimore, ku mund të themi se nuk kemi hasur asnjë problem në drejtim të realizimit të procesit mësimor në këto 2 institucione. Konkretisht 2 grupe praktikash viti II dhe 2 grupe praktikash viti III kanë vazhduar të realizojnë orët e praktikës mësimore në Spitalin Rajonal të Fierit gjatë të dy semestrave.
- Edhe me insistimin e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Vlorë dhe Fier edhe këtë vit akademik' i kemi zhvilluar praktikat mësimore me 2 turne (8.00-12.00 dhe 12.00-16.00) duke bërë të mundur që numri maksimal i studentëve në një pavion të mos i kalojë 20 - 22 studentë.
- Gjatë këtij viti akademik 1 anëtare e DKSH u rregjistrua për studimet doktorale në Universitetin e Elbasanit, në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.
- Sipas informacioneve zyrtare të marra nga UISH, *kalueshmëria e studentëve të programit Bachelor në Infermieri Mami në provimin e shtetit për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të infermierit, në provimin e praktikës ka qenë 73% dhe në provimin e teorisë 66%. kalueshmëria e studentëve të programit Bachelor në Infermieri të përgjithshme në provimin e praktikës ka qenë 83% dhe në provimin e teorisë 77%.*
- *Rregjistrimet bachelor për këtë vit akademik, 2022- 2023, u realizuan në masën 100% për programet Bachelor ndërsa në programet Master rreth 70%.*
- Gjatë vitit akademik 2022-2023 nga universiteti u siguruan *rregjistra mësimor* të cilët evidentojnë pjesën e ngarkesës mësimore të realizuar nga stafi ynë akademik, ndërkohë në këto rregjistra mungonte mundësia e evidentimit të frekuentimit të orëve mësimore nga studentët.
- *Vlerësimi i performancës së pedagogëve.* Procesi mësimor është zhvilluar rregullisht, nuk ka patur raportime për mos zhvillim të orëve mësimore. Frekuentimi ka qenë i rregullt si nga stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme apo dhe nga studentët. Provimet vlerësuese janë zhvilluar normalisht sipas afateve dhe orareve të paracaktuara të publikuara paraprakisht si në ambjentet e Fakultetit, faqen zyrtare të UV dhe në faqen facebook të FSH. Për vlerësimin e performancës së pedagogëve të FSH u përdor formulari "Vlerësimi i performancës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme" miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 52 datë 20.04.2017. Këto performanca janë depozituar në departamentet perkatese dhe pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Universitet. Në këtë anketim kanë marrë pjesë 98% e studentëve frekuentues në programet Bachelor, 99.5% e studentëve frekuentues në programin Master Profesional në Infermieri Pediatrike. ndërsa në ciklin Master Shkencor kemi 91.5%, në Infermieri Kirurgjikale 96.5%, në Infermieri Patologjike 87%. Përgjithësisht 80% e studentëve kanë dhënë vlerësim pozitiv në drejtim të mësimdhënies si edhe rubrikave të tjera të përfshira në anketim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

STRUKTURA AKADEMIKE PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023

Shpërndarja e studentëve në kurset dhe vitet e studimit:

| Cikli i Parë i Studimeve të FSH |                               |                 |           |                               |                                       |           |                                |                                       |           |       |                                   |                                                   |           |
|---------------------------------|-------------------------------|-----------------|-----------|-------------------------------|---------------------------------------|-----------|--------------------------------|---------------------------------------|-----------|-------|-----------------------------------|---------------------------------------------------|-----------|
|                                 | Viti I                        |                 |           | Viti II                       |                                       |           | Viti III                       |                                       |           | Total | Të diplomuar në 2023              |                                                   |           |
|                                 | Bcs<br>Inf.<br>e<br>Për<br>gj | Bcs<br>Ma<br>mi | Tot<br>al | Bcs<br>Inf.<br>e<br>Për<br>gj | Bcs<br>Ma<br>mi<br>Infe<br>rmi<br>eri | To<br>tal | Bcs<br>Inf.<br>e<br>Për<br>gje | Bcs<br>Ma<br>mi<br>Infe<br>rmi<br>eri | To<br>tal |       | Bc<br>s<br>Inf<br>.e<br>Pë<br>rgj | Bc<br>s<br>M<br>am<br>i<br>Inf<br>er<br>mi<br>eri | To<br>tal |
| Stud<br>entë                    | 243                           | 121             | 364       | 189                           | 80                                    | 269       | 188                            | 83                                    | 271       | 904   | 179                               | 62                                                | 241       |
| Mj                              | 32                            | 2               | 34        | 19                            | 1                                     | 20        | 25                             | 1                                     | 26        | 80    |                                   | 0                                                 |           |
| F                               | 211                           | 96              | 307       | 170                           | 97                                    | 267       | 163                            | 80                                    | 243       | 1017  |                                   | 62                                                |           |

| Cikli i Dytë i Studimeve të DI |        |                                         |                                              |           |         |                                                         |                                                      |           |       |                                           |                                                 |                                              |  |
|--------------------------------|--------|-----------------------------------------|----------------------------------------------|-----------|---------|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|-----------|-------|-------------------------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------|--|
|                                | Viti I |                                         |                                              |           | Viti II |                                                         |                                                      |           | Total | Të diplomuar në 2022                      |                                                 |                                              |  |
|                                | MS     | MP<br>Infer<br>mieri<br>Patolo<br>gjike | MP<br>Infer<br>mieri<br>Kirur<br>gjikal<br>e | To<br>tal | M<br>S  | MP<br>Inf<br>er<br>mie<br>ri<br>Pat<br>olo<br>gji<br>ke | MP<br>Infe<br>rmi<br>eri<br>Kir<br>urg<br>jika<br>le | To<br>tal |       | MS<br>Shken<br>ca<br>Infer<br>miero<br>re | MP<br>Infe<br>rmie<br>ri<br>Pato<br>logji<br>ke | MP<br>Infer<br>mieri<br>Kirur<br>gjikal<br>e |  |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|                  |    |    |    |    |    |   |   |    |  |    |    |    |
|------------------|----|----|----|----|----|---|---|----|--|----|----|----|
| Stu<br>den<br>të | 20 | 21 | 37 | 78 | 16 | 0 | 0 | 16 |  | 17 | 22 | 43 |
| M                | 3  | 3  | 5  | 11 | 1  | 0 | 0 | 1  |  | 82 |    |    |
| F                | 17 | 18 | 32 | 67 | 15 | 0 | 0 | 15 |  |    |    |    |

| Cikli i Dytë i studimeve të DKSH |        |       |              |
|----------------------------------|--------|-------|--------------|
|                                  | Viti I | Total | Të diplomuar |
| Studentë                         | 13     | 13    | 14           |
| Meshkuj                          | 0      | 0     |              |
| Femra                            | 13     | 13    |              |

KAPACITETET AKADEMIKE TË FSH  
Personeli Akademik i Fakultetit të Shëndetit

Nëntor 2023

| Nr.                         | Emër Mbiemër   | Pozicioni              | Titulli akademik | Grada shkencore     |
|-----------------------------|----------------|------------------------|------------------|---------------------|
| 1                           | Aurela Saliaj  | Dekane                 | Prof.asoc.       | Doktore e Shkencave |
| Departamenti i Infermierisë |                |                        |                  |                     |
| 1.                          | Majlinda Zahaj | Drejtuese departamenti | Lektore          | Doktore e Shkencave |



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|                                    |                  |                             |                  |                     |
|------------------------------------|------------------|-----------------------------|------------------|---------------------|
| 2.                                 | Vitori Hasani    |                             | Prof.asoc.       | Doktore e Shkencave |
| 3.                                 | Afërdita Nikaj   |                             | Lektore          | Doktore e Shkencave |
| 4.                                 | Mimoza Çanga     |                             | Lektore          | Doktore e Shkencave |
| 5.                                 | Evis Alushi      | Këshilltare akademike       | Lektore          | Doktore e Shkencave |
| 6.                                 | Denada Selfo     |                             | Lektore          | Doktore e Shkencave |
| 7.                                 | Sonila Nika      |                             | Asistent/Lektore | Doktorante          |
| 8.                                 | Majlinda Rakipaj |                             | Asistent/Lektore | MSH                 |
| 9.                                 | Neda Cakerri     |                             | Asistent/Lektore | MSH                 |
| 10.                                | Deona Taraj      |                             | Asistent/Lektore | MSH                 |
| 11.                                | Vasilika Prifti  |                             | Asistent/Lektore | Doktorante          |
| Departamenti i Kujdesit Shëndetsor |                  |                             |                  |                     |
| 1.                                 | Emirjona Kiçaj   | Drejtuese departamenti      | Asistent/Lektore | Doktorante          |
| 2.                                 | Aurela Saliqaj   | Drejtuese e grupit kërkimor | Profesor         | Prof.asoc.          |
| 69 | Univer<br>sity of<br>Salento<br>(Itali)                             | Zhvillim<br>i i<br>mësimd<br>hënies<br>dhe<br>kërkimit<br>të<br>përbash<br>kët | Marrëveshje<br>mirëkuptimi | 24.10.<br>2022 | Gjuhë e<br>Huaj     | 1.Kryerjen e projekteve të përbashkëta kërkimore.<br>2.Shkëmbimin e anëtarëve të fakultetit në varësi të aftësive financiare të partnerëve.<br>3.Shkëmbimin e botimeve shkencore.<br>4.Botimin e abstrakteve dhe punimeve kërkimore në revistat shkencore.<br>5.Shkëmbimin e informacionit për organizimin e ngjarjeve, konferencave shkencore ndërkombëtare etj.<br>6.Shkëmbimi i programeve mësimore dhe programeve të studimit, përfshirë studimet pasuniversitare.                                                                                                                                                                                                                                          | Program<br>Studimi<br>double<br>degree:<br>Program<br>Bachelor në<br>“Gjuhësi të<br>Aplikuar në<br>Fushën e<br>Turizmit”                             |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|    |                            |                                                                                                                                                                                  |                       |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|----|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                            |                                                                                                                                                                                  |                       |         |                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 7.Shkëmbimi i librave shkollorë, materialeve dhe mjeteve mësimore, monografive dhe botimeve të tjera.<br>8.Mundësia e shkëmbive të studentëve të doktoratës për periudhat e studimit, trajnimet praktike, workshope, konferencat etj. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| 70 | Projekt i me akronim SMART | Qendrat e inovacionit smart për zhvillimin e të menduarit inovativ dhe sipërmarrës për të lehtësuar zhvillimin e zgjidhjeve inteligjente të qëndrueshme në ballkanin perëndimor. | Projekt Erasmus+ CBHE | 01.2023 | Projekti SMART mbështet IAL-të partnere nga vendet e synuara, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi, për të kapërcyer rolin e tyre si ofrues njohurish dhe për t'u bërë formësues aktivë të ekosistemit rajonal të inovacionit duke bashkëpunuar me aktorë të ndryshëm. | Përmbushja e paketave të punës dhe raportimi brenda afateve.                                                                                                                                                                          | 1.Adresimit të sfidave të IAL-ve në fushën e specializimit inteligjent dhe zhvillimit të kompetencave të ndërlidhura me inovacionin dhe sipërmarrjen me futjen e moduleve të reja të të mësuarit të zgjuar të lidhura me specializimin dhe qasjet inovative të mësimdhënies në kurrikulat e IAL-ve, duke përfshirë mësimdhënie online, mësimin |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|  |  |  |  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|--|--|--|--|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  |  |  |  |  | ndërkurrikula<br>r dhe<br>lëvizshmëri<br>virtuale.<br>2.Mbështetje<br>e zhvillimit<br>profesional të<br>stafit<br>akademik të<br>IAL-ve në<br>fushën e<br>zhvillimit të<br>kompetencav<br>e të<br>inovacionit<br>dhe<br>sipërmarrjes<br>për kërkesat e<br>specializimit<br>inteligjent së<br>bashku me<br>praktikat e<br>mësimdhënie<br>s hibride dhe<br>online.<br>3.Ngritja e 7<br>Qendrave<br>SMART<br>Inovacioni në<br>IAL dhe<br>integrimi i<br>tyre në<br>strukturën<br>ekzistuese të<br>IAL-ve.<br>4.Lehtësimit<br>të<br>bashkëpunimi<br>t të |
|--|--|--|--|--|--|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

|    |                                         |                                                                                                                                                                                           |                             |             |                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|----|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                         |                                                                                                                                                                                           |                             |             |                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                 | qëndrueshëm<br>ndërmjet<br>IAL-ve dhe<br>sektorit të<br>biznesit<br>nëpërmjet<br>Rrjetit të<br>Shkëmbimit<br>të Njohurive<br>SMART.<br>5.Inkurajimit<br>të punësimit<br>të studentëve<br>dhe stafit<br>sidhe<br>lëvizshmërisë<br>(virtuale).<br>Vlera 73536<br>EUR |
| 71 | Projekt<br>i me<br>akroni<br>m<br>INTEC | Qendrat<br>ndërkom<br>bëtare të<br>kompete<br>ncës<br>inxhinie<br>rike për<br>të rritur<br>zhvillim<br>in e<br>qëndrue<br>shëm të<br>lëvizsh<br>mërisë<br>në mal të<br>zi dhe<br>shqipëri | Projekt<br>Erasmus+<br>CBHE | 01.202<br>3 | Përparimi<br>në<br>lëvizshmëri<br>në e<br>qëndruesh<br>me është<br>adresuar në<br>Axhendën<br>2030 për<br>Zhvillim të<br>Qëndrueshë<br>m. Të<br>bashkosh<br>inxhinierë<br>dhe<br>ekspertë<br>nga<br>disiplina të<br>ndryshme<br>(inxhinieri | Përmbushja e paketave të punës dhe<br>raportimi brenda afateve. | Zbatimi i<br>trajtimeve në<br>IAL merr<br>parasysh të<br>dhënat dhe<br>nevojat e<br>palëve të<br>interesuara<br>dhe<br>përmirëson<br>bashkëpunimi<br>n dhe<br>punësimin e<br>të<br>diplomuarve<br>përmes më<br>shumë<br>përpjekjeve<br>arsimore duke<br>adresuar   |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
SENATI AKADEMIK

|  |  |  |  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|--|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|  |  |  |  | elektronike,<br>mekanike,<br>automobilis<br>tike) është<br>çelësi për të<br>ecur<br>përpara.<br>INTEC<br>trajton<br>mungesën e<br>aftësive<br>multidisipli<br>nare dhe<br>bashkëpunim<br>mit midis<br>palëve të<br>interesuara<br>në fushën e<br>lëvizshmëri<br>së së<br>qëndruesh<br>me për të<br>gjeneruar<br>një ndikim<br>pozitiv në<br>zhvillimin e<br>gjelbër<br>rajonat në<br>Shqipëri<br>(AL) dhe<br>Mal të Zi<br>(MN) | veçanërisht të<br>nxënësit me<br>probleme<br>reale. Të<br>mësuarit e<br>përzier dhe<br>aftësitë e buta<br>për<br>inxhinierët<br>sjellin<br>përmbajtje<br>dhe veçori të<br>veçanta në<br>këtë projekt.<br>Për<br>bashkëpunim<br>afatgjatë me<br>palët e<br>interesuara<br>dhe<br>shkëmbim të<br>qëndrueshëm<br>ndërkombëtar<br>të njohurive,<br>projekti<br>parashikon<br>ngritjen e 6<br>Qendrave<br>Ndërkombëta<br>re të<br>Kompetencës<br>Inxhinierike<br>(IECC) në<br>IAL-të<br>pjesëmarrëse<br>në AL dhe<br>ME.<br>Vlera 78624<br>EUR |
|--|--|--|--|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

**Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:**

### **7. Politikat e kërkimit shkencor**

#### **Fakulteti i Shëndetit**

Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor për Qendren Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik.

- A. Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor të qendra janë përcaktuar bazuar në planin Strategjik të UV dhe politikave kombëtare të kërkim zhvillimit. Në funksion të kësaj, referuar Linja strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar, të Planit Strategjik të UV nëpërmjet projektit Gold Health Care ka promovuar UV në nivel ndërkombëtar, por njëkohësisht edhe rritjen e kapaciteteve, falë shkëmbimit të informacionit dhe drejtimit të studimeve të përbashkëta me impakt për vendet bashkëpunuese dhe më gjerë. Në kuadër të projektit është nënshkruar edhe një marrëveshje ndërinsitucionale që ndër të tjera synon në rritje të aksesit në të dhëna për kërkimim shkencor nga studiuesit e përfshirë në projekt.
- B. Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombetare. Ky prioritet i vendosur synohet të realizohet nëpërmjet kërkimeve të përbashkëta në vendet e përfshira në projekt, dhe në botimin e një produkti shkencor me impakt afat-gjatë për vendet e përfshira.
- C. Partneritete të qëndrueshme për aplikime projektsh ndërkombëtare në kuadër të programeve të financuara nga Komuniteti Evropian ku përfshihen Programet ndërkufitare dhe transnacionale të kooperimit, Horizon 2020, Erasmus+, është një prioritet tjetër strategjik i vendosur. Në kuadër të kësaj është arritur aderimi në një konsorcium për të aplikuar me universitete prestigjioze Europiane në kuadër të thirrjes Erasmus + KA220. Gjithashtu, stafi i qendrës në cdo rast, apo aktivitet ndërkombëtar synoj të krijoj partneritete bashkëpunimi për projekte me impakt për rritjen e cilësisë së mësimdhënies por edhe të kapaciteteve të stafit të UV.
- D. Linja strategjike Nr 2/ Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata. Për realizimin e këtij prioriteti strategjik ka filluar ngritja e kapaciteteve të stafit akademik aktual për të ofruar programe ndërkombëtare studimi në rradhë të parë duke mundësuar ofrimin e moduleve aktuale të studimit në gjuhën angleze apo gjuhë tjetër të BE duke rritur ofertën akademike për studentët e huaj. Pesë anëtarë të stafit janë në gjendje të ofrojnë modulet e tyre në gjuhë të huaj.
- E. Linja strategjike Nr 3: Kërkim shkencor i përbashkët sipas standardeve ndërkombëtare. Bazuar në këtë prioritet stafi i qendrës ka pasur gjithmonë qëllim përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor. Në projektet dhe punimet e kryera nga stafi i qendrës për vitin akademik 2022-2023, kemi një përfshirje të gjerë të studenteve si pjesë e grupeve të punës apo supervizim të studimeve nga ana e stafit akademik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- F. Politikat stimuluese financiare për studentët dhe pedagogët e UV për të marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare kanë gjetur reflektim në rimbursim të shpenzimeve që kanë të bëjnë me tarifat e regjistrimit për pjesëmarrje. Ndërkohë që, shpenzimet në shkollë trajnuese apo vizita kërkimore janë mbuluar nga vetë programi apo projekti.
- G. Këtë vit qendra organizoi Konferencën Ndërkombëtare 2023 me bashkëpunim të tre IAL-ve Shqiptare, Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë dhe me pjesëmarrje të lektorëve kyc të huaj, me reputacion shkencor të rëndësishëm. Kjo ishte e para konferencë e këtij lloji, organizuar në fushën e shëndetit. Gjithashtu në bashkëpunim, është organizuar një konferencë me koordinatör Universitetin e Elbasanit si dhe ëorkshop i dedikuar në konferencën ndërkombëtare të LUMEN INTERNATIONAL. Këto aktivitete shkencore i kanë dhënë stafit të qëndrës dhe Fakultetit të Shëndetit mundësi për rritje profesionale por njëkohësisht të jenë faktor dhe konkurrenca në arenën ndërkombëtare të kërkimeve në fushën e kujdesit shëndetësor dhe shëndetit publik. Këto punime ishin reflektim i punës kërkimore të kryer nga qendra me impakt jo vetëm në rritjen e vizualitetit të UV në arenën ndërkombëtare por edhe për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kujdesit shëndetësor të ofruar nëpërmjet rritjes profesionale dhe edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetit.
- H. Botimi i artikujve shkencore ka qënë kryesisht në Buletinin e Universitetit. Publikime nga stafi i qëndrës në Buletinin e UV është një tregues për qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e këtij organi botues. Në të gjitha botimet evidentohet fryma e punës në grup jo vetëm në nivel departamenti, por edhe ndërfakultetore dhe në nivel ndërkombëtar. Duhet më shumë inkurajim i stafit për të nxitur botime në revista shkencore prestigjioze me faktor impakti.
- I. Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri është një prioritet tjetër që duhet të nxitet për realizim, nga ana e stafit për ndërmarrjen e projekteve të përbashkëta me impakt edukativ-social dhe ekonomik.
- J. Laboratori Mikrobiologjik Klinik këtë vit ka implementuar me sukses miniprojektet e planifikuara.
- K. Stafi akademik dhe ndihmës akademik është angazhuar edhe në detyra në mbështetje të institucionit dhe në mbarëvajtje të procesit mësimor si monitorime në provime dhe detyra të tjera institucionale duke i zbatuar ato me korrektesë.
- L. Stafi akademik me grada dhe tituj shkencor ka udhëhequr dhe studentët e Masterit Shkencor në Infermieri për zhvillimin e mikrotezës. Gjithashtu, profesorët janë dhe udhëheqës të studentëve të doktoraturës.

Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor për Departamentin e Infermierisë, DI

Fusha kryesore e kërkimit shkencor në Departamentin e Infermierisë, ashtu sikurse në Fakultetin e Shëndetit është fusha e Shërbimeve Shëndetësore Infermirore. Bazuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të FSH, këtë vit akademik aktiviteti shkencor i stafit dhe studentëve të programeve që ofron DI i përmbahet fushave të studimit të përcaktuara, të cilat janë:

- Promovimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Kujdesi shëndetësor bazuar në protokollet bashkëkohore;
- Lehtësimi i individëve dhe familjeve që përballen ose përshtaten me sëmundjen e tyre
- Shkenca e dhembshurisë: fundi i jetës dhe kujdesi paliativ.
- Shkenca e të dhënave: Gjenerimi dhe përdorimi i grupeve të mëdha dhe komplekse të të dhënave për të vlerësuar, parashikuar dhe mbrojtur shëndetin e pacientit dhe popullatës gjatë gjithë jetëgjatësisë

Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor për Departamentin e Kujdesit Shëndetësor, DKSH

Fusha kryesore e kërkimit shkencor në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor është fusha e Shërbimeve Shëndetësore, me fokus Shërbimin Infermieror dhe Shëndetin Publik. Bazuar në Strategjinë e Kërkimit Shkencor të FSH 2017-2022, këtë vit akademik fushat prioritare të kërkimit shkencor për DKSH janë përcaktuar si më poshtë:

- Strategjitë e promovimit për shëndetin e nënës dhe fëmijës
- Cilësia e jetës së pacientëve të hospitalizuar me patologji kronike.
- Evidentimi i faktorëve që ndikojnë në shëndetin e komunitetit.

Realizimi i objektivave dhe synimeve bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor për DKSH

Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 në fillim të vitit akademik DKSH ka përcaktuar fushat e kërkimit shkencor specifik, mbi të cilat janë ngritur si tematikat e projekteve kërkimore, si temat e diplomave.

Pedagogët tanë janë angazhuar në programe zhvillimi dhe kërkimore të BE si Horizon 2020 dhe kanë konkuruar me sukses në thirrjen për "Projekte të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor" (PIKSH), të shpallur nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2021. Janë 2 projekte të aplikuara nga pedagogia e DKSH, Prof. Asoc Aurela Saliaj që janë shpallur fitues. Një tjetër projekt i BE, "Vitalise Project" është shpallur fitues në korrik të 2023 dhe tashmë është në proces të zbatimit, në të cilin është anetare e grupit të punës pedagogia e DKSH, prof/asoc Rezarta Lalo.

Janë organizuar projekte të financuara si studime fizibiliteti (N=6) në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor.

Në nivel departamenti gjatë vitit akademik 2022-2023 janë botuar në total 10 artikuj të kategorisë full paper në revista ndërkombëtare me bord editorial të indeksuara në Pubmed, Thomson Reuters, Orcid etj me seli botimi në vendet e Bashkimit Europian (BE) dhe Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD).

Stafi akademik i DKSH është prezantuar me punime në 12 konferenca/aktivitete shkencore të zhvilluara jashtë vendit, kryesisht në vendet e BE dhe Ballkanit Perëndimor si dhe në





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

konferenca/aktivitete shkencore ndërkombëtare të zhvilluara brenda vendit, kryesisht në Tiranë, dhe Vlorë. Artikujt e botuar në revista brenda vendit përfshijnë botime kryesisht në Buletinin e Universitetit dhe në Revistën Shkencore "Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor" Botim i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.

Realizimi i objektivave dhe synimeve bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor për DI

Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 në fillim të vitit akademik, DI ka përcaktuar fushat e kërimit shkencor specifik, mbi të cilat janë ngritur si tematikat e projekteve kërkimore, si temat e diplomave.

Gjatë vitit 2022-2023, Departamenti i Infermierisë ka fituar dhe përmbyllur me sukses 1 projekt kombëtar për Kërkim-Zhvillim dhe Infrastrukturë kërkimore në thirrjet e hapura nga AKKSHI: Efektet anësore të vaksinave COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara Financuar nga AKKSHI) me drejtuese Dr. Majlinda Zahaj.

Gjithashtu Msc Vasilika Prifti, anëtare e D.I., është anëtare e Projektit- CHILDREN FIRST, Grupi i ndërtimit të Pytesorit, Marie Curie doctoral networks MSCA, për lidhjen e ndotjes mjedisore në shkolla me shëndetin e moshave shkollore.

Në mbështetje të objektivave për kërkimin shkencor anëtarët e DI kanë botuar 12 artikuj në revista shkencore ndërkombëtare me bord editorial me seli botimi në vendet e Bashkimit Europian (BE), botime në Buletinin e Universitetit të Vlorës dhe në Revistën Shkencore "Profesionistët e Kujdesit Shëndetësor" Botim i Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë.

Stafi akademik i DI gjithashtu është prezantuar me punime në 20 konferenca brenda dhe jashtë vendit kryesisht në vendet e BE dhe Ballkanit Perëndimor.

### **Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore**

Qëllimi dhe objektivat e kërimit shkencor

- të mundësojë përfshirjen e stafit akademik dhe të studentëve në punë kërkimore
- të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel rajonal dhe kombëtar;
- të ofrojë shërbime, në përputhje me misionin e tyre

Mbështetja institucionale e stafit në lidhje me punën kërkimore, kryesisht me trajtimin e vecantë të tyre për leje akademike, por edhe trajtim financiar për pjesëmarrje në konferenca, ërkshope, kongrese, si edhe për botime në revista brenda dhe jashtë vendit ka qenë një risi për këtë vit akademik. Mbështetja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

gjithashtu për mobilitete e stafit dhe studenteve në kuadër të programit Erasmus+. Dhe lehtësimi i procedurave për realizimin e tyre

Përmes vijimit dhe përmbylljes së projekteve është siguruar bazë materiale për disa laboratore, në biologji, shkencë detare, Qendrën Kërkimore Shkencore.

### Fakulteti i Shkencave Human

Politikat e kërkimit shkencor

Përcaktohen në strategjitë për kërkimin shkencor të njëjësive bazë dhe QSAB-së. Në një qasje më të gjerë, ato synojnë përafrimin e kërkimit shkencor në fakultet me standardet ndërkombëtare, përfshirjen e stafit, sidomos atij të ri, në kërkim dhe projekte kërkimore, lidhjen më të ngushtë të kërkimit me tregun e punës dhe rajonin.

a. Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor.

Në lidhje me kërkimin shkencor prioritet kryesor për vitin akademik 2022-2023 ka qenë sigurimi i fondeve për realizimin e projekteve kërkimore me financim vendas dhe/ose të huaj, kryesisht për mbështetjen e ciklit të tretë të studimeve, por edhe për angazhimin e stafit në projekte kërkimore për nevojat vetjake studimore. Përfshirja e studentëve të ciklit të tretë në këto projekte ka qenë prioritet.

b. Objektivat dhe synimet bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor.

Veprimtaritë e kërkimit shkencor në fakultet zhvillohen në përputhje me zhvillimet në drejtimin e gjerë të shkencave humane, dhe më ngushtë, të atyre sociale, juridike, filologjike dhe të edukimit dhe lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me prioritetet dhe objektivat strategjike sektoriale të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022, përmes projekt-propozimeve që synojnë të përmbushin prioritetin A në këtë strategji (Politika A. Përmirësimi i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar në shërbim të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SHTI)), duke iu përgjigjur qëllimeve 2 (Rritja e investimeve për infrastrukturën e kërkimit shkencor dhe efektivitetit të përdorimit të tyre.) dhe 5 (Garantimi i aksesit për marrjen e informacionit mbi rezultatet e kërkimit shkencor dhe përdorimi i pakushtëzuar i të dhënave shkencore.) nën këtë prioritet, duke u përpjekur të realizojë këto objektiva strategjikë:

Qëllimi 2/Objektivi : Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastruktures kombëtare të kërkimit shkencor për çështjet e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mjedisit, energjisë, shkencat e materialeve, ICT, albanologjisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Qëllimi 5/ Objektivi 1. Garantimi i aksesit të hapur on-line për të gjitha botimet shkencore të financuara me fonde publike;

si dhe prioritetin C në këtë strategji (Politika C. Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve të shoqërisë civile, medias dhe publikut për rolin e Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë.), duke iu përgjigjur qëllimit 1 dhe objektivit 3 të këtij qëllimi (Qëllimi 1: Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut dhe institucioneve vendimmarrëse mbi rëndësinë e shkencës, inovacionit dhe teknologjisë/ Objektivi 3. Rritja e ndërgjegjësimit në shoqërinë shqiptare për rolin e dobisë e kërkimit shkencor si aktivitet publik).

Përmes projekt-propozimeve synohet të përmirësohen mjetet metodologjike kërkimore dhe logjistike në shkencat humane. Duke i bërë publike rezultatet e arritura përmes botimeve dhe artikujve të ndryshme, si dhe duke i promovuar ato përmes mjeteve të ndryshme të informimit (website, rrjete sociale, takime shkencore etj.), duke mundësuar aksesueshmërinë e këtyre rezultateve për të gjithë ata kërkues të interesuar, duke i bërë këto rezultate të shfrytëzueshme prej tyre, projekt-propozimet synojnë t'i përgjigjen dhe të përmbushin më së miri objektivat dhe prioritetet e sipërpërmendura. Këto të fundit janë në një linjë edhe strategjitë ndërkombëtare për akses të hapur ndaj botimeve dhe shkencës së hapur (open science), duke i bërë rezultatet e kërkimit të dobishme për të gjitha palët e interesuara dhe duke mos i mbajtur ato të kufizuara vetëm brenda rretheve akademike e shkencore.

Në këtë kuptim, në mënyrë më specifike, ato kanë synuar:

1. lidhjen e kërkimit me mësimdhënien;
2. harmonizimin e qasjeve lokale me ato globale;
3. futjen e koncepteve të reja shkencore në disiplinat shkencore që mbulon fakulteti;
4. përdorimin e rezultateve shkencore për adresimin e çështjeve me natyrë gjuhësore, kulturore, letrare, edukative dhe juridike;
5. testimin e hipotezave dhe provimin e tyre;
6. hartimin e projekteve kërkimore për realizimin e programeve të veçanta të studimit, sidomos të ciklit të tretë të studimeve;
7. kryerjen e veprimtarive shkencore në ruajtje të etikës shkencore në kërkim dhe integritetit akademik;
8. përfshirjen e studentëve në kërkim;
9. përparimin e njohurive të thelluara shkencore.

Në këtë kuadër, FSHH ka realizuar disa aktivitete/iniciativa gjatë vitit akademik 2022-2023:

- leksione të hapura;
- konferenca nga njësitë bazë.
- angazhim në projekte kërkimore dhe shkencore me fonde të BE-së dhe/ose kombëtare/të brendshme;
- pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit nga personeli i fakultetit;
- përfshirje e studentëve në aktivitete shkencore;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

- etj.

**Fakulteti i Ekonomisë**

*Qëllimi dhe objektivat e kërkimit shkencor*

Qëllimi dhe objektivi i kerkimit shkencor të Departamentit të Biznesit është në funksion të misionit dhe vizionit të Departamentit të Biznesit dhe misionit të UV.

Objektivat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

- Angazhimin dhe përfshirjen e stafit akademik në veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore ndërkombëtare.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore me të gjithë pedagogët e departamentit të Biznesit.
- Rritja e numrit të projekteve kërkimore konkurruese (në bashkëpunim me departamentet e tjera);
- Rritje e numrit të botimeve, të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson Reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik- student dhe komunitetit të biznesit nëpërmjet takimeve, seminareve, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Krijimi i një sistemi që inkurajon kërkimin shkencor cilësor duke përdorur dhe aplikuar incentiva që stimulojnë dhe vlerësojnë publikimet më cilësore të stafit akademik dhe duhet të synojë rritjen e bashkëpunimit shkencor të stafit të fakultetit me kërkues të huaj.
- Organizimin e Konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare studentore duke patur në fokus këndvështrimin e të rinjve për çështje sensitive të shoqërisë globale.

*Organizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në departament*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Punën kërkimore shkencore të personelit akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencor në revista me faktor impakti, pjesëmarrjes përmes aplikimit, apo implementimit të projekteve për vitin akademik 2022 – 2023

### *Politikat e kërkimit shkencor*

Politikat e kërkimit shkencor janë të orientuara në:

- Angazhimin dhe përfshirje e stafit akademik në veprimtari kërkimore shkencore ndërkombëtare përmes ofrimit të mbështetjes financiare nga UV. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë dy herë në vit mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto aktivitete
- Angazhimi i stafit akademik të Departmentit të Biznesit në hartim dhe zbatim projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në nivel Universiteti.
- Bashkëveprim i qendrës kërkimore/shkencore në nivel fakulteti me të gjithë pedagogët e departamentit të Biznesit.
- Rritje e numrit të botimeve të punimeve krijuese e shkencore në revista ndërkombëtare me faktorë të lartë impakti dhe të indeksuara sipas Thompson reuter dhe/ose Scopus.
- Nxitje dhe mbështetje e shkrimit të monografive dhe librave të hartuar nga bashkëpunimi i stafit akademik sipas profileve
- Mbështetjen dhe zhvillimin e konferencave shkencore ndërkombëtare dhe ëorkshop-eve në nivele departamenti dhe fakulteti si dhe bashkëpunim për organizimin e konferencave ndërkombëtare në partneritet me universitete prestigjioze Europiane.
- Nxitja e studentëve drejt kërkimit shkencor dhe kërkesave praktike të rajonit.
- Rritje e bashkëpunimit staf akademik, student dhe komuniteti biznesit nëpërmjet takimeve, seminare, praktikave dhe aktiviteteve të përbashkëta.

### *4.5 Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien*

Rëndësia e lidhjes së mësimdhënies me kërkimin shkencor është një kusht i domosdoshëm në konkretizimin e materialeve teorike në praktikë. Rëndësia e integritetit të kërkimit shkencor në mësimdhënie ka orientuar personelin akademik te Departamentit të biznesit në:

- Përditësimin e leksioneve të bazuara në shëmbuj konkretë të marrë nga tregu lokal, kombëtar dhe global.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Përfshirjen e studentit në projekte të lëndës apo detyra kursi përmes sjelljes së rasteve të studimit apo praktikave nga realiteti shqiptar dhe më gjërë.
- Nxitjen e studentëve për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore – shkencore.
- Pjesëmarrja e personeli akademik në projekte, konferenca, shkrimi dhe botimi i artikujve në revista janë një element tjetër tregues.

### **8. Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor mbi mësimdhënien.**

#### **Fakulteti i Shëndetit**

Fakulteti i Shëndetit, Vlorë është një institucion i arsimit të lartë i orientuar drejt kërkimit shkencor. Roli i punës kërkimore është të mbështesë mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe të pasurojë përvojën si për studentët ashtu dhe stafin akademik. Universiteti i Vlorës inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare.

Integrimi i studentëve në kërkimin shkencor ka qënë objektiv i procesit kërkimor për vitin 2022-2023. Kjo reflektohet si në mbrojtjen e diplomës me tezë ku studenti zhvillon një studim të caktuar nën udhëheqjen e stafit akademik të FSH.

Gjithashtu, studentët e FSH kanë qënë pjesë aktive edhe në veprimtaritë promociionale që fakulteti ka zhvilluar jo vetëm me ofrim të shërbimeve por edhe me prezantime tematikash. Departamenti i Infermierisë ka organizuar tashmë Konferencën e Dytë studentore, me punimet shkencore ndër vite të të diplomuarve në programin e Masterit Shkencor në Shkenca Infermierore në FSH: “Integrimi i i evidencave të kërkimit shkencor në përmirësimin e kujdesjeve infermierore.

#### **Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore**

Kërkimit shkencor dhe mesimdhënia në FSHTN është e lidhur me prezantimin e punës individuale të stafit akademik se pari në njesinë baze dhe në grupin mesimor. Është kërkuar informacion i vijueshëm ndaj stafit akademik në lidhje me rezultatet e kërkimit në çdo rast kur janë paraqitur në konferenca, simpoziume apo aktivitete të tjera shkencore me qëllim përfshirjen e njesi se baze me gjetjet e tyre.

Jane nxitur studentet që së bashku me stafin akademik udhëheqës në temat e diplomave të prezantojnë punimet e tyre në ëorkshope, simpoziume, konferenca studentore si edhe nxitjen e dhe promovimin e botimeve të tyre.

Departamenti i shkencat kompjuterike, departamenti i biologjisë, Departamenti i Fizikës kanë organizuar gjatë vitit akademik ëorkshop ku studentet kanë prezantuar projektet e tyre kërkimore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

QKSH e FSHTN shërben për zhvillimin e projekteve kërkimore sidomos për studentë të MS në Biologji Mjedisore, duke vënë në dispozicion aparatet matëse për studimet bio-kimike, bio-fizike, analiza të ndotjes etj.

### **Fakulteti i Shkencave Humane**

Veprimtaria kërkimore-shkencore në Fakultetin e Shkencave Humane është e lidhur ngushtë me fushat që mbulojnë programet e studimit që ofron fakulteti. Përmes hulumtimeve shkencore nga stafi akademik të realizuara në fusha të ndryshme studimi, në përputhje me programet e studimit të ofruara nga fakulteti, synohet edhe pasurimi i mëtejshëm i syllabuseve dhe përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies.

Katër njësitë bazë të fakultetit si edhe Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanistike kanë pasur objektiv gjatë këtij viti integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien dhe të nxënësit, si edhe përfshirjen aktive të studentëve në këtë proces.

Studentët e programeve master, në përfundim të ciklit të studimeve zhvillojnë projektet e tyre kërkimore (temat e diplomës) të udhëhequr nga stafi akademik i FSHH. Udhëheqësi akademik i studentit ka një ekspertizë të thelluar në fushën që studenti zgjedh të studiojë, duke e orientuar këtë të fundit drejt çështjeve të lidhura ngushtësisht me programin e tij të studimit dhe që kërkojnë hulumtim të mëtejshëm, duke mbështetur, kështu, avancimin e studentit në kërkimin shkencor dhe në fushën e tij të studimit.

Studentët, gjithashtu, janë përfshirë rregullisht në aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore e promovuese të organizuara nga fakulteti. Ata janë përfshirë në mënyrë aktive në konferencat e organizuara nga fakulteti, gjatë procesit organizimit të tyre, si dëgjues, apo pjesëmarrës me prezantimet e punimeve të tyre.

Studentët kanë qenë edhe në fokus të aktiviteteve promovuese të mbajtura nga QSAB, e cila ka organizuar aktivitete me qëllim promovimin e krjimitarisë së studentëve dhe studiuesve të rinj.

Studentët kanë qenë, po ashtu, në fokus të dy workshopeve të organizuara nga DE, ku ata vetë janë përfshirë si bashkëpunëtorë, si edhe kanë pasur mundësi të prezantohen e promovohen përmes punimeve të tyre.

Stafi akademik i FSHH ka realizuar një sërë botimesh në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si edhe ka mbajtur prezantime të punimeve shkencore në konferenca ndërkombëtare. Vlen të theksohet se temat e hulumtimeve shkencore të stafit akademik janë të lidhura ngushtësisht me fushat dhe programet e studimit ku ata japin mësim. Stafi akademik i FSHH ka prioritet integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien, duke thelluar e njohuritë dhe studimet sipas programeve të studimit në njësitë e tyre bazë, duke integruar produktet e kërkimit shkencor në syllabuse dhe në lëndët që ata mbulojnë gjatë mësimdhënies, duke adresuar nevojat që lindin gjatë procesit të mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë së kësaj të fundit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

Stafi i DE, duke pasur një fokus të vecantë lidhjen e kërkimit shkencor me procesin e dukimit, gjatë këtij viti ka realizuar disa studime ku janë përfshirë studentët e programeve të ofruara nga vetë DE, studime që kanë pasur për qëllim identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të studentëve, identifikimin e rrugëve për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit, identifikimin e nevojave për mbështetje psikoemocionale të studentëve, etj.

Prioritet ka qenë përfshirja e studentëve të ciklit të tretë në projekte kërkimore, si kusht për realizimin e planit doktoral individual. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, si anëtarë grupi pune apo të tërthortë, si pjesëmarrës në aktivitetet në kuadër të projekteve kërkimore, të 5 doktorantët janë angazhuar në këto veprimtari.

### Fakulteti i Ekonomisë

Rëndësia e lidhjes së mësimdhënies me kërkimin shkencor është një kusht i domosdoshëm në konkretizimin e materialeve teorike në praktikë. Rëndësia e integritetit të kërkimit shkencor në mësimdhënie ka orientuar personelin akademik të Departamentit të Ekonomisë në:

- § Përditësimin e leksioneve të bazuara në shembuj konkretë të marrë nga tregu lokal, kombëtar dhe global.
- § Përfshirjen e studentit në projekte të lëndës apo detyra kursi përmes sjelljes së rasteve të studimit apo praktikave nga realiteti shqiptar dhe më gjërë.
- § Nxitjen e studentëve për organizimin e konferencave studentore
- § Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte, konferenca, shkrimi dhe botimi i artikujve në revista janë një element tjetër tregues.

Rritja e vazhdueshme e cilësisë në mësimdhënie është reflektuar edhe në:

- § Punën kërkimore shkencore të personelit akademik me kohë të plotë për marrjen e gradave shkencore dhe titujve akademik (i gjithë personeli akademik i Departamentit të Ekonomisë i përket kategorise profesor dhe lektor).
- § Pjesëmarrjen në mësimdhënie të personelit të ftuar me grada dhe tituj nga institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.
- § Përdorimit të literaturës dhe teknikave bashkëkohore dhe interaktive në mësimdhënie.
- § Krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me sektorin privat dhe publik në realizimin e programeve tona akademike lidhur me realizimin e praktikave mësimore për studentët.
- § Mundësimi i shkëmbimit të eksperiencës në mësimdhënie të personelit akademik përmes shfrytëzimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për programet e mobiliteteve - International Credit Mobility Programs (Erasmus+ KA1) që Universiteti Ismail Qemali ka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

nënshkruar me Universitete prestigjioze në përputhje me kapacitetet pritëse mësimdhënëse, infrastrukturën në funksion të mësimdhënies, diversitetin kulturor dhe social.

§ Vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie përmes pyetësorëve drejtuar studentëve, dhe mundësimi i rezultateve të pyetësorit personelit akademik.

**9. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësia bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;**

Në vitet 2022-2023 janë botuar 8 velle të Buletinit Shkencor (ISSN 2310-6719):

- Buletini Shkencor Nr 5 Vol 1 2022
- Buletini Shkencor Nr 5 Vol 2 2022
- Buletini Shkencor Nr. 5, Vol. 3
- Buletini Shkencor Nr.6, Voll 1, 2023
- Buletini Shkencor Nr. 6, Vol. 2 – 2023
- Scientific Bulletin-KnoëHub Special Edition 2023
- Buletini Shkencor Nr.6 Vol.3-2023
- Buletini Shkencor - special edition vol.3, 2023 – Simpoziumi

### Fakulteti i Shëndetit

Departamenti i Kujdesit Shëndetësor ishte iniciator i realizimit të Simpoziumit Shkencor të realizuar në bashkëpunim edhe me Departamentin e Infermierisë në Qershor 2023 me temë: “Kërkimi Shkencor si orientues i politikave shëndetësore”. Qershor 2023 Vlorë. Simpoziumi shkencor ‘Kërkimi shkencor si orientues i Politikave Shëndetësore’ i organizuar nga DKSH, Fakulteti i Shëndetit, Universiteti ‘Ismael Qemali’ Vlorë shërbeu si një nga mënyrat e promovimit të produkteve të arritura prej projekteve të kërkim-zhvillimit dhe infrastrukturës, të realizuara në kuadër të bashkëpunimit me Agjensinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Ky simpozium përmbante tre sesione bazë gjatë të cilave do të prezantohen rezultatet e gjithë projekteve të realizuara fal bashkëpunimit me AKKSHI:

- Orientimi i politikave shëndetësore, si produkt final i kërkimit shkencor në Fakultetin e Shëndetit do të prezantojë gjithë spektrin e bashkëpunimit të FSH me AKKSHI.
- Orientimi i politikave në Shërbimin Shëndetësor Parësor – do të prezantojë gjetje dhe rekomandime për disa aspekte të mjekësisë komunitare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË SENATI AKADEMIK

- Orientimi i politikave institucionale për zhvillimin e fëmijëve – do të diskutojëq monitorimin në vazhdimësi të zhvillimit psikomotor të parashkollorëve.

Departamenti i Infermierisë organizoi më datën 5 Nëntor 2022, Konferenca e Dytë Studentore me temë: “Integrimi i evidencave të kërkimit shkencor në përmirësimin e kujdeseve infermierore II”. Konferenca kishte qëllimin për t’u dhënë zë punëve studimore të studentëve të këtij fakulteti, për t’i bërë ata të ndihën të angazhuar në jetën akademike, duke i dëgjuar për të rejtat e kërkimit shkencor në fushën e infermieristikës, për të përmbushur objektivin e përbashkët staf akademik - student, në tërheqjen e sa më shumë studenteve për të dhënë kontribut në të gjitha fushat e shëndetësisë në vendin tonë. Punimet që u referuan ishin të gjitha punime të studentëve tanë, të ciklit të dytë të studimeve, Master-Shkencor.

Në këtë konferencë u referuan 20 tema të cilat ishin të fokusuar;

- në situatën e pandemisë së COVID-19 që kaloi mbarë bota si edhe vendi ynë, dukë dhënë dëshmi konkrete dhe praktike të kujdesit infermieror,
- në kujdesin infermieror dhe kërkimin infermieror gjithëpërfshirës si edhe
- në kujdesin për nënën, fëmijën, familjen dhe kërkimi shkencor infermieror në këtë drejtim.

Qendra Kërkimore Shkencore për Shëndetin Publik, SRC4ph, Universiteti i Vlorës “Ismael Qemali”, në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Universitetin e Elbasanit dhe Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë, organizon Konferencën Ndërkombëtare 2023: Besimi në njohuri për shëndet më të mirë. Konferenca ishte një forum shkencor 2 ditor me pjesëmarrje të personaliteteve nga brenda dhe jashtë vendit, lektorëve kyc dhe sesioneve paralele ku u paraqitën 50 punime orale dhe 34 punime poster. Pjesëmarrja ishte e gjerë me profesionistë nga të gjitha disiplinat e shkencave mjekësore, akademike, kërkues dhe studentë. 300 pjesëmarrës ditën e parë dhe 150 pjesëmarrës ditën e dytë. Pothuajse i gjithë stafi i Fakultetit të Shëndetit u paraqitën në këtë konferencë me punimet e tyre. Konferenca u akreditua nga ASCK.

Gjithashtu SRC4ph ishte bashkorganizatore e Konferencës: KNIS-2022 - Konferenca e VI-të Ndërkombëtare Infermierore në Specialitete, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Departamenti i Infermieristikës, 19-20 Maj 2022, Elbasan.

Bashkeorganizatore i ëorkshopit Ndërkombëtar në kuadër të ëorlde Empoëring LUMEN Congress on Multidimensional Education ëELCOME 22 November 22nd-26th, 2022 Iasi, Romania & online ëorldeide, në bashkëpunim me LUMEN CONFERENCE CENTRE

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet një përmbledhje e veprimtarisë kërkimore sipas elementeve përberes të planit kërkimor-shkencor e kategorizuar në nivel të 3 departamenteve, numrit të punimeve, aktiviteteve dhe pjesëmarrjes së stafit në trajnime. *Per llogaritjen e numrit total të botimeve dhe pjesëmarrjes në konferencë është marrë në konsideratë botimi dhe referimi si autor i parë kontribues.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË  
SENATI AKADEMIK

Tabelë përmbledhëse e Veprimtaria Kërkimore–Shkencore te stafit akademik të Fakultetit të Shëndetit për vitin akademik 2022-2023.

| Projekte kërkimore shkencore                         |                                               |                |                                                                         |
|------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------|-------------------------------------------------------------------------|
| Fakulteti i Shëndetit                                |                                               |                |                                                                         |
Të ardhura të trashëguara nga viti 2021 janë 117,494,876 lekë. Për vitin 2022 janë çelur për përdorim 168,692,498 lekë Tërësia e çeljeve (të trashëguara nga viti 2021 dhe të çelura nga të ardhurat e vitit 2022) përbëjnë planin e thesarit prej 212,576,634 lekë

Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për t'u realizuar në vitin 2022. Pjesa e papërdorur kanë kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2023.

Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave të institucionit për vitin 2022.



**Siç paraqitet në grafik këto të ardhura janë përdorur:**

- Për investime 8 %.
- Për studim projekte 0 %.
- Për kërkimin shkencor 15 %.
- Për paga e shpërblime 6 % (paga+pagesa e orëve mbi normë në sistemin me kohë të plotë).
- Për sigurime shoqërore 2%.
- Për shpenzime operative 61 %.
- Për transferta tek individët 6.6 %.
- Për transferta me jashtë 0.04 %.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE SENATI AKADEMIK

TË ARDHURAT FAKTIKE TE NSTITUCIONIT TE REALIZUARA PËR VITIN 2022

| KRIJIMI |                                                          |             | SHPENZIMI 2022           |                          |          |             |
|---------|----------------------------------------------------------|-------------|--------------------------|--------------------------|----------|-------------|
| I       | TË ARDHURA E VETA                                        | Lekë        | Emërtimi                 | REALIZIMI PER VITIN 2022 | Llogaria | Lekë        |
| 1       | Qera                                                     | 43,000      | A. Përdorimi             | Studim projekte          | 230      | 0           |
| 2       | Tarife per regjistrimin ne arsimin e larte               | 3,873,000   |                          | Investime                | 231      | 6,339,700   |
| 3       | Tarifa shkolli                                           | 83,425,387  |                          | Paga e shpërblime        | 600      | 4,352,744   |
| 4       | K/Dytesore                                               |             |                          | Sigurime shoqërore       | 601      | 1,852,366   |
| 5       | Sa marre teper                                           | 15,346      |                          | Shpenzime operative      | 602      | 46,073,692  |
| 6       | Vertetime                                                | 2,467,650   |                          | Transf. jashtë           | 605      | 272,163     |
| 7       | Sponsorizime                                             | 1,690,325   |                          | Transf. tek individë     | 606      | 4,936,381   |
| 8       | 5% Garanci                                               | 533,545     |                          | Shpenzime per k.shkencor | 602      | 11,246,131  |
| 9       | Te tjera te ardhura nga shitja e mallrave dhe sherbimeve | 3,033,505   |                          |                          |          |             |
| I       | Totali te ardhurave te realizuara per 2022               | 95,081,758  |                          |                          |          |             |
|         | Te trashguara nga viti 2021                              | 117,494,867 | B. Përdorur              |                          |          | 75,073,177  |
| II      | GRANTI I BUXHETIT TE SHETIT                              |             | C. Trashëgohe te ardhura |                          |          | 137,503,448 |
| 1       | Paga (600)                                               | 383,875,320 | C. Trashëgohe buxheti    |                          |          | 25,971,459  |
| 2       | Sigurime Shogore Shendetesore (601)                      | 56,821,602  |                          |                          |          |             |
| 3       | Shpenzime operative(602)                                 | 19,236,277  |                          |                          |          |             |
| 4       | Shpenzime kerkim shkencor (602)                          | 7,962,502   |                          |                          |          |             |
| 4       | Bursa(606)                                               | 34,353,154  |                          |                          |          |             |
| 5       | Investime (231)                                          | 25,574,007  |                          |                          |          |             |
| II.     | Totali I Grantit te buxhetit                             | 527,822,862 |                          |                          |          |             |
| III     | TOTALI I TE RADHURAVE PER VITIN 2022                     | 740,399,487 |                          |                          |          |             |

#### 4. Shpenzimet

Gjatë vitit 2022 shpenzimet gjithsej janë realizuar 74 % e financimit vjetor.

##### -Sipas formave të financimit:

- Buxheti i brendshëm (Granti konkurrues, TVSH - projekte, kërkimi shkencor nga buxheti) janë realizuar 0 % (Kontratat ishin 1-vit dhe janë mbartur për vitin 2022)
- Projekti të huaja 69 %.
- Shpenzimet nga Granti mësimdhënies është realizuar 96%
- Shpenzimet nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 55%.

##### -Sipas zërave të shpenzimit:

- Shpenzimet për investimet 13.2%.
- Shpenzimet për paga dhe për sigurime shoqërore 95.84 %.
- Shpenzimet për shpenzime operative 68 %.
- Transferta me jashtë 45 %.
- Transferta tek individët 80 %
- Bursat për studentët 78 %.
- Shpenzimet për Kërkimi shkencor 62 % nga të cilat: Nga buxheti 7 %, nga të ardhurat 55 %

Më i detajuar realizimi i buxhetit 2022 sipas formave të financimit dhe ndarjes së zërave të shpenzimeve paraqitet në tabelën "Realizimi i buxhetit për vitin 2022 fakti\_12 mujorit".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

| Artikulli       | EMERTIMI                                                    |                   | GRANT NGA<br>BUXHETI | TE<br>ARDHURAT | TOTALI      |
|-----------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------|----------------|-------------|
| 230,231<br>9450 | Studim Projektme<br>Investime                               | PLAN BUXHETI      | 137,824,700          | 154,513,000    | 292,337,700 |
|                 |                                                             | FAKT              | 15,761,500           | 11,246,131     | 27,007,631  |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 122,063,200          | 143,266,869    | 265,330,069 |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 11%                  | 7%             | 9%          |
| 600,601<br>9450 | Paga Personeli<br>Sig.Shoq.Shendetesore                     | PLAN BUXHETI      | 440,696,922          | 10,000,000     | 450,696,922 |
|                 |                                                             | FAKT              | 439,778,557          | 6,205,110      | 445,983,667 |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 918,365              | 3,794,890      | 4,713,255   |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 99.8%                | 62.1%          | 99.0%       |
| 602<br>9450     | Shpenzime Korente                                           | PLAN BUXHETI      | 19,236,277           | 58,308,423     | 77,544,700  |
|                 |                                                             | FAKT              | 10,054,598           | 46,073,692     | 56,128,290  |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 9,181,679            | 12,234,731     | 21,416,410  |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 52.3%                | 79.0%          | 72.4%       |
| 606<br>9450     | BURSA<br>Transferta per Buxhetet<br>familjare dhe individet | PLAN BUXHETI      | 34,343,652           | 5,160,000      | 39,503,652  |
|                 |                                                             | FAKT              | 22,652,462           | 4,936,000      | 27,588,462  |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 11,691,190           | 224,000        | 11,915,190  |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 66.0%                | 95.7%          | 69.8%       |
| 605<br>9450     | Transferime korente te<br>jashtme                           | PLAN BUXHETI      | 0                    | 300,000        | 300,000     |
|                 |                                                             | FAKT              | 0                    | 272,163        | 272,163     |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 0                    | 27,837         | 27,837      |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 0                    | 90.7%          | 90.7%       |
| 602-231<br>9770 | Kerkimi Shkencor<br>Shpenzime 602<br><br>Investime 231      | PLAN BUXHETI      | 17,711,809           | 18,708,000     | 36,419,809  |
|                 |                                                             | FAKT              | 12,842,157           | 12,379,731     | 25,221,888  |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 4,869,652            | 6,328,269      | 11,197,921  |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 72.5%                | 66.2%          | 69.3%       |
| Totali          | Total<br>Buxhti(Granti+Te<br>ardhura)                       | PLAN<br>BUXHETI   | 649,813,360          | 246,989,423    | 896,802,783 |
|                 |                                                             | FAKT              | 501,089,274          | 81,112,827     | 582,202,101 |
|                 |                                                             | DIFERENCA         | 148,724,086          | 165,876,596    | 314,600,682 |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% | 77%                  | 33%            | 65%         |
| 602-231<br>9770 | Financimi I Huaj                                            | PLAN BUXHETI      |                      |                | 26,244,000  |
|                 |                                                             | FAKT              |                      |                | 15,268,000  |
|                 |                                                             | DIFERENCA         |                      |                | 10,976,000  |
|                 |                                                             | REALIZIMI NE<br>% |                      |                | 58.2%       |
|                 |                                                             |                   | Plani                | Fakti          | Realizimi % |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|                  |             |             |     |
|------------------|-------------|-------------|-----|
| Total Buxheti UV | 923,046,783 | 597,470,101 | 65% |
|------------------|-------------|-------------|-----|

➤ **Paga e shpërblime – Artikulli 600.**

Pagat për vitin 2022 janë mbuluar kryesisht me fondet nga Granti për mësimdhënie dhe nga të ardhurat e UV-së në masën 99 %.

- Paga nga Granti për mësimdhënie është realizuar prej 99.8 %.
- Paga nga të ardhurat e institucionit janë realizuar në masën 62.1 %.

Me këtë fond page janë përballuar pagat e stafit me kohë të plotë, akademik, ndihmës akademik dhe administrativ si edhe pagat e stafit me kontratë (i marrë në tërësi paga e honorarë ,orë mësimore mbi normë, orë pedagogë të jashtëm):

- Pagat e punonjësve përbejnë 50 % të planit vjetor.
- Pagesa e orëve suplementare dhe pedagogë të jashtëm është 5 % e planit vjetor.

Më të detajuara të dhënat për orët suplementare dhe stafin e jashtëm paraqiten si në tabelën

**“Pagesa e orëve mësimore për vitin 2021 - 2022”.**

| Fakultetet    | Orë suplementare të parashikuara | Orë suplementare të realizuara | Vlera totale e paguar |
|---------------|----------------------------------|--------------------------------|-----------------------|
| FE            | 10,125                           | 10,020                         | 9,533,150             |
| FSHT          | 12,527                           | 13,063                         | 11,365,706            |
| FSH           | 11,195                           | 7,600                          | 6,191,154             |
| FSHH          | 16,380                           | 18,125                         | 17,134,810            |
| <b>TOTALI</b> | <b>50,227</b>                    | <b>48,807</b>                  | <b>44,224,820</b>     |

Pagesa e orëve suplementare janë miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 21 datë 15. 08.2022 dhe Vendimin nr. 48 datë 19.12.2022.

➤ **Fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore – Artikulli 601.**

Fondi për sigurime shoqërore është shpenzuar për likuidimin e detyrimeve që institucioni ka ndaj Degës së Sigurimeve Shoqërore si kontribut për punonjësit e vet. Ky zë është realizuar në masën 98% për fondin e planifikuar nga granti dhe 93% për fondin e planifikuar nga të ardhurat e UV-së . Nga ky fond është mbuluar fondi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore i llogaritur për pagesat e kryera për stafin me kohë të plotë dhe pedagogët e jashtëm për orët mësimore që këta të fundit kanë zhvilluar për vitin akademik 2021 – 2022.

➤ **Shpenzime operative – Artikulli 602.**

Shpenzimet operative për vitin 2022 janë mbuluar nga të ardhurat dhe Granti për mësimdhënie. Shpenzimet operative janë realizuar në masën 72 % ndaj parashikimit.

- Shpenzimet operative nga Granti për mësimdhënie janë realizuar në masën 52% ndaj planit
- Shpenzimet operative nga të ardhurat e institucionit janë realizuar 79 % ndaj planit.

Shpenzimet operative për vitin 2022 janë realizuar kryesisht për:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

- Ujë, energji, telefon e tjera të kontraktuara.
- Mirëmbajtje ndërtesa dhe mjetet e transportit.
- Materiale për mbrojtje personale dhe shërbime dezinfektimi.
- Printime, kancelari, furnizime të ndryshme materiale mësimore e tjera.
- Udhëtim e dieta të ndryshme (transport e hotel për ekspeditat e praktika mësimore në terren).
- Pagesa Senati Akademik, Bordi i Administrimit.
- Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë së godinave.
- Mirëmbajtje të objekteve ndërtimore dhe mjedise të jashtme, riparime e mirëmbajtje të ndryshme paisjesh.
- Shpenzime për qira (Ambjentet e FSH-së).

Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative mbulojnë disa veprimtari të domosdoshme që i shërbejnë procesit mësimor, shërbimi i sigurimit dhe i ruajtjes së godinave, si edhe shpenzimet për qera, pasi Fakulteti i Shëndetit zhvillon procesin mësimor në ambiente me qera.

Në formë të përmbledhur jepen në tabelën "Shpenzime për mallra dhe shërbime (602) Viti 2022". Përqindja e realizimit në këtë tabelë është llogaritur me planin e miratuar gjatë vitit 2022 nga Bordi i Administrimit për kryerjen e shpenzimeve operative për të gjitha objektet, pavarësisht nga çelja në degën e thesarit. Ky zë shpenzimesh është realizuar në total 70%. Në disa zëra mosrealizimi i shpenzimeve operative të planifikuara ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të disa prokurimeve të cilat nuk janë përfunduar brenda vitit.

| Kodi llog | Grup shpenzimi/2021                    | Grant / Leke |           |     | Të ardhura/Leke |            |     | Totali / Leke |            |     |
|-----------|----------------------------------------|--------------|-----------|-----|-----------------|------------|-----|---------------|------------|-----|
|           |                                        | Plan         | Fakt      | %   | Plan            | Fakt       | %   | Plan          | Fakt       | %   |
| 6020      | Materiale zyre dhe te pergjithshme     | 3,290,000    | 2,044,268 | 62% | 2,160,000       | 1,316,760  | 61% | 5,450,000     | 3,361,028  | 62% |
| 6021      | Materiale dhe sherbime speciale        | 7,201,840    | 1,534,666 | 21% | 1,670,000       | 1,043,024  | 62% | 8,871,840     | 2,577,690  | 29% |
| 6022      | Sherbime nga te trete                  | 5,744,437    | 5,371,690 | 94% | 12,804,223      | 11,669,263 | 91% | 18,548,660    | 17,040,953 | 92% |
| 6023      | Shpenzime transporti                   | 0            |           | 0%  | 1,350,000       | 1,199,384  | 89% | 1,350,000     | 1,199,384  | 89% |
| 6024      | Shpenzime udhetimi                     |              |           | 0%  | 2,500,000       | 2,404,450  | 96% | 2,500,000     | 2,404,450  | 96% |
| 6025      | Shpenzime per mirembajtje te zakonshme |              |           | 0%  | 2,420,000       | 1,997,226  | 83% | 2,420,000     | 1,997,226  | 83% |
| 6026      | Shpenzime per qiramarrje               |              |           | 0%  | 11,287,200      | 11,145,968 | 99% | 11,287,200    | 11,145,968 | 99% |
| 6027      | Shpenzime per detyrime                 | 3,000,000    | 1,104,006 | 37% | 1,000,000       | 0          | 0%  | 4,000,000     | 1,104,006  | 28% |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|      |                              |                   |                   |              |                   |                   |              |                   |                   |              |
|------|------------------------------|-------------------|-------------------|--------------|-------------------|-------------------|--------------|-------------------|-------------------|--------------|
|      | dhe kompesime legale         |                   |                   |              |                   |                   |              |                   |                   |              |
| 6029 | Shpenzime te tjera operative |                   |                   | 0%           | 21,117,000        | 15,297,617        | 72%          | 21,117,000        | 15,297,617        | 72%          |
|      | <b>Totali</b>                | <b>19,236,277</b> | <b>10,054,630</b> | <b>52.3%</b> | <b>56,308,423</b> | <b>46,073,692</b> | <b>70.3%</b> | <b>75,544,700</b> | <b>56,128,322</b> | <b>70.0%</b> |

- Zëri i shpenzimeve operative "Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes" për vitin 2022 zë 15 % të shpenzimeve operative gjithsej.
- Zëri i shpenzimeve operative "Shpenzime për qeramarrje" për vitin 2022 zë 15 % të shpenzimeve operative gjithsej.
- Zëri i shpenzimeve operative "Shpenzime te tjera operative" për vitin 2022 zë 20 % të shpenzimeve operative gjithsej, ku përfshihen shpenzime për pagesën e anëtarëve të Bordit Senatit, organizim evnetsh, pritje përcjellje etj.

Në vitin 2022 nuk ka patu vonesa në afatin e likuidimit të kreditorëve për shpenzimet operative. Kjo për arsye të realizimit të të ardhurave në mënyrë periodike dhe fondeve në dispozicion nga Granti për mësimdhënie.

➤ **Shpenzime operative për transferta me jashtë – Artikulli 605.**

Transferta me jashtë (605) është realizuar 90% e fondit të çelur për këtë qëllim. Në kuotën 300,000 lekë e planifikuar në llogarinë 605 nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 janë përfshirë pagesat për kuota anëtarësimi dhe pjesëmarrje të institucionit tonë në organizime, projekte dhe aktivitete me institucionet e huaja. Kuotat e antarësimit vjetor të EUCEN, MCU, ETEN, BSUN dhe anëtaresime të reja të pritshme për vitin 2022.

➤ **Transferta tek individët – Artikulli 606.**

Shpenzimet për transferta tek individët janë realizuar në masën 70 % e planit vjetor. Bursat e studentëve janë realizuar 66 % të fondit të akorduar. Këto fonde ndahen:

- **Rimbursim të pagesave të studentëve.** Fondi prej 361,898 lekë është përdorur për rimbursim të pagesave të kryera nga studentët që kanë paguar tarifën e plotë të shkollimit, por që kanë përfituar përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit sipas vendimeve të BA-së.
- **Transfertat për rastet e daljes në pension ose Shpërblim në rast fatkeqsie.** Për shpërblimin e personelit të UV-së që kanë dalë në pension për vlerën 934,483 lekë. Ky fond është marrë nga fondi i veçantë pjesë e fondit të pagave dhe ka kaluar në këtë artikull rast pas rasti sipas Vendimeve të BA-së.
- **Bursat e studentëve.** Për vitin 2022 fondi i bursave të studentëve është realizuar 66 % e fondit të akorduar. Në këtë artikull siç është theksuar përfshihen bursat e studentëve (transferta tek individët) për ciklin e parë të studimeve. Fondi gjithsej është 34,343,652 lekë. Ky fond është akorduar në Grantin për bursat e studentëve në fillim të vitit. Procedura e trajtimit me bursë të studentëve ka kaluar në disa faza përgjatë vitit akademik. Trajtimi i studentëve me bursë deri më 31.12.2022 është bazuar në Vendimet e Bordit të Administrimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 39 datë 23.01.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar" janë miratuar me vendime të Bordit të Administrimit:

-Me bursë të plotë sipas kriterëve për studentët në nevojë ekonomike gjithsej 190 studentë.

-Me mesatare me notën 9-të e lartë gjithsej 97 studentë.

Bursat sipas vendimeve të BA-së për vitin 2021-2022.

| UV           | Studente ekselente |                  | Studente ne nevojë |                   |
|--------------|--------------------|------------------|--------------------|-------------------|
| Fakulteti    | Nr. Studente       | Efekt.Financ     | Nr. Studente       | Efekt.Financ      |
| FE           | 19                 | 1,710,000        | 36                 | 3,303,154         |
| FSHH         | 22                 | 1,980,000        | 45                 | 4,050,000         |
| FSH          | 29                 | 2,610,000        | 67                 | 6,030,000         |
| FSHT         | 27                 | 2,430,000        | 42                 | 3,780,000         |
| <b>TOTAL</b> | <b>97</b>          | <b>8,730,000</b> | <b>190</b>         | <b>17,163,154</b> |

**Pagesat e bursave.**

| Viti akademik<br>2021-2021 | Paguar Nr. Stud<br>Ndihmë Ekonomike | Vlera Ndihmë<br>Ekonomike | Paguar Nr. Stud<br>ekselentë | Vlera ekselentë   |
|----------------------------|-------------------------------------|---------------------------|------------------------------|-------------------|
|                            | 186                                 | 14,385,462                | 96                           | 8,267,000         |
| <b>TOTAL</b>               | <b>338</b>                          |                           |                              | <b>22,652,462</b> |

Janë paguar në zbatim të vendimeve të Bordit të Administrimit 92 studentë që përfitojnë bursë financiare sipas rezultateve (mesatare e ponderuar 9 – të e lartë e vitit paraardhës për vitin e dytë e të tretë, mesatare e ponderuar 9 – të e lartë e shkollës së mesme për vitin e parë) dhe 187 studente në nevojë.

Nuk janë paguar 5 studente (1 ekselente dhe 4 studentë në nevojë), pasi nuk kanë dorëzuar numër llogarie.

➤ **Shpenzime për investime - artikulli 230/231.**

Investimet e kryera për Universitetin financohen në formën e:

**Financimi i brendshëm (Buxheti) :**

-Grant konkurrues për investime për kërkimin Shkencor janë fondet që përballohen nga buxheti i shtetit. Për vitin 2022 janë akorduar 6,840,000 lekë për projektin "Qendër Digitale Simulatore për profesionistët e shëndetit" realizuar 100%

- Janë rimbursuar TVSH për projektet me financim të huaj 2,909,307 lekë, përkatësisht për projektin Entral, KnoëHub, Success.

Gjithashtu Gjatë vitit 2022 institucioni është financuar nga MAS për ndërtimin e dy laboratoreve përkatësisht :





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**SENATI AKADEMIK**

| Kodi projektit | Emertimi i projektit                               | Vlera e plotë | Financuar nga     | Financuar nga    |
|----------------|----------------------------------------------------|---------------|-------------------|------------------|
|                |                                                    | e             | Buxheti I Shtetit | Te ardhurat e UV |
|                |                                                    | projektit     |                   |                  |
| 18BD407        | Ndertimi I dy laboratoreve digital                 | 9,588,000     | 8,908,000         | 680,000          |
| 18BD408        | Perafrimi I kapaciteteve Akademike te Mesimdhenies | 7,308,000     | 6,853,000         | 454,000          |

Projektet u financuan 90% nga MAS dhe 10 % nga te ardhurat e veta te institucionit. Projektet u realizuan 100% brenda vitit 2022.

Kuota e planifikuar për vitin 2022 nga transfertat e kushtëzuar (ardhurat) e institucionit është 149,747,000 lekë. dhe realizimi Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është 6,339,700 lekë ku janë realizuar procedurat "Blerje detektor tymi", "Ngritja e laboratorit për departamentin e gjuhëve të huaja", Bashkëfinancimi për projektet e MAS"

**-Investimet - Artikulli 231:**

Në këtë grup përfshihen shpenzimet për investime për: ndërtime dhe rikonstruksione objektsh, blerje pajisje për auditorë dhe zyra, blerje pajisje laboratorike për laboratorët mësimorë dhe shkencorë, fond biblioteke etj. Projektet e investimeve të financuara paraqiten në tabelën "Investime viti 2022 - të ardhurat e institucionit".

Treguesit e realizimit të investimeve janë relativisht të ulët, pasi në investimet e planifikuara për vitin 2022 vetëm objekti "Ndërtimi i godinës së Fsh-së" zë 72 % të investimeve.

**Ngritja e laboratorit për departamentin e gjuhëve të huaja:**

Bazuar në shkresën e Fakultetit të Shkencave Humane nr. 1936/14 Prot., datë 28.12.2021, është planifikuar ngritja e laboratorit për departamentin e gjuhëve të huaja në vlerën 5000,000 lekë.

Ngritja e laboratorit u realizua në masën 3,972,000 lekë brenda vitit 2022. Kontrata pritet të perfundojë në mars të vitit 2023.

➤ **Fondet dhe projektet për kërkimin shkencor.**

Për kërkimin shkencor ka dy forma financimi:

- Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues.
- Fondi nga projekti i AKKSH-it
- Fondi për kërkimin shkencor nga të ardhurat.

• **Fondi nga projekti i AKKSH-it**

| Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë |                     |                      |                   |       |                             |                                |                     |
|-------------------------------------|---------------------|----------------------|-------------------|-------|-----------------------------|--------------------------------|---------------------|
| Nr .                                | Titulli i projektit | Agjencia Ekzekutuese | Drejtues Projekti | Fusha | Vlera e financuar nga AKKSH | Shpenzuar deri në fund të 2022 | Trasheguar për 2023 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|   |                                                                                                                      |                                     |                            |                                    | I                |                  |                  |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|----------------------------|------------------------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1 | Shqipëria në shkrimet e udhëtimit të periudhës paskomuniste (1990-)                                                  | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Prof. Ass. Armela Panajoti | Shkenca Sociale dhe Albanologjike  | 1,094,310        | 0                | 1,094,310        |
| 2 | Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë                                       | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Dr. Majlinda Zahaj         | Shëndetësia dhe shkencat mjekësore | 1,168,507        | 0                | 1,168,507        |
| 3 | Ngritja e database rajonal të vlerësimit të zhvillimit psikomotor dhe socio emocional të fëmijëve 0-6 vjeç.          | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Prof.As. Aurela Saliq      | Shëndetsia dhe Shkencat Mjekësore  | 2,252,372        | 1,149,151        | 1,103,221        |
| 4 | Projekti Zhvillimi I ekspertizës akademike, bazuar në studime ndërdisiplinore për aplikime të sistemeve eksperte.... | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Dr. Eva Cipi               | Teknologji Informatik              | 2,000,000        | 1,461,038        | 538,962          |
| 5 | Projekti Efikasiteti i shërbimit shëndetësor virtual pas pandemisë CoVid                                             | Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë | Prof.As. Aurela Saliq      | Shëndetsia dhe Shkencat Mjekësore  | 1,447,313        | 1,082,133        | 275,000          |
| 5 | <b>Totali</b>                                                                                                        |                                     |                            |                                    | <b>7,962,502</b> | <b>3,692,322</b> | <b>4,180,000</b> |

Për periudhën Janar- Dhjetor 2022 janë realizuar 2,174,859 lekë shpenzim ose 46 % e planit vjetor.

**Fondi për kërkimin shkencor nga të ardhurat.**

Nga fondet e veta të UV-së janë parashikuar 14,902,849 lekë në mbështetje të Kërkimit Shkencor për stafin e UV-së.

U realizuan miniprojektet e Fakulteteve 500, 000 lekë për secilin Fakultet.

Realizimi për vitin 2022 është 11,246,131 lekë ose 75 % e buxhetit vjetor.

**Fondi për kërkimin shkencor me Grant konkurrues:**

Gjatë vitit 2022 institucioni është financuar nga MAS për ndërtimin e dy laboratoreve përkatësisht :

| Kodi | Emertimi i projektit | Vlera e plotë | Financuar nga | Financuar nga |
|------|----------------------|---------------|---------------|---------------|
|------|----------------------|---------------|---------------|---------------|





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

| projektit |                                                    | e         | Buxheti I Shtetit | Te ardhurat e UV |
|-----------|----------------------------------------------------|-----------|-------------------|------------------|
|           |                                                    | projektit |                   |                  |
| 18BD407   | Ndertimi I dy laboratoreve digital                 | 9,588,000 | 8,908,000         | 680,000          |
| 18BD408   | Perafrimi I kapaciteteve Akademike te Mesimdhenies | 7,308,000 | 6,853,000         | 454,000          |

Projektet u financuan 90% nga MAS dhe 10 % nga te ardhurat e veta te institucionit. Projektet u reaktizuan 100% brenda vitit 2022.

Gjithashtu në buxhetin e vitit 2022 përfshihet fondi për projektet e infrastrukturës financuar nga AKKSHI-i në vitin 2021 i cili është transferuar për vitin 2022 sipas shkresës së MFE nr. 7638/1 prot., datë 10.05.2022 "Transferim fondi për shpenzimet kapitale" për ndërtimin e Qendrës digitale simulatore për profesionistët e shëndetit.

Në lidhje me projektin e financuar nga AKKSH-i është lidhur kontrata nr. 1688/18 prot., dt 28.12.2021 e cili përfundoj në muajin Gusht2022.

➤ **Projektet e Huaja**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka aktualisht projektet e mëposhtme me financim të huaj.

Për vitin 2022 është planifikuar të disbursohen 64,825,000 Lekë nga te cilat janë realizuar për periudhën Janar - Dhjetor 2022 është 38,990,762 Lekë ose 60 % e palnit për vitin 2022.

Nga financimet e huaja janë planifikuar për vitin 2022 investime nga granti i BE (Blerje laborator,paisje kompjuterike etj) ne vlerën 215,000 Eur, nga të cilat janë relizuar per periudhën Janar-Dhjetor 125,000 Eur (projekti Knoëhub,Entral, TTO4Food, Success) ose 58% e parashikimit per investime.

| Kodi projektit | Emertimi i projektit | Vlera e plotë e projektit | Viti i fillimit te projektit | Vitit i përfundimit te projektit | Buxheti I kontraktuar | Plani i buxhetit viti 2022 | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën (31.12.2021) | REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore) | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale |
|----------------|----------------------|---------------------------|------------------------------|----------------------------------|-----------------------|----------------------------|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| 18CJ923        | FoLATE               | 3,974                     | 2020                         | 2023                             | 3,456                 | 1,152                      | 1,157                                                                      | -                                                        | 1,157                                                                 |
| 18CJ926        | STEAMedu             | 8,104                     | 2021                         | 2024                             | 7,047                 | 379                        | -                                                                          | -                                                        | -                                                                     |
| 18CJ920        | KNOWHUB              | 16,955                    | 2019                         | 2022                             | 14,744                | 2,444                      | 2,628                                                                      | 1,895                                                    | 4,523                                                                 |
| 18CJ924        | SUCCESS              | 9,991                     | 2020                         | 2023                             | 8,688                 | 4,405                      | -                                                                          | 4,434                                                    | 4,434                                                                 |
| 18CJ928        | TTO4FOOD             | 11,457                    | 2020                         | 2022                             | 9,963                 | 4,364                      | 4,663                                                                      | 5,704                                                    | 10,367                                                                |
| 18CJ921        | TANGRAM              | 19,164                    | 2019                         | 2022                             | 16,289                | 3,575                      | 25,750                                                                     | 5,710                                                    | 31,460                                                                |
| 18BD831        | AFRIMED              | 13,500                    | 2019                         | 2022                             | 10,800                | 1,000                      | 447                                                                        | 2,509                                                    | 2,956                                                                 |
| 18BX501        | PHAREM               | 21,802                    | 2018                         | 2021                             | 18,959                | 2,477                      | 4,375                                                                      | 1,107                                                    | 5,482                                                                 |
| 18BE003        | Business Clubs       | 14,211                    | 2018                         | 2021                             | 12,357                | -                          | 1,873                                                                      | -                                                        | 1,873                                                                 |
| 18CJ922        | EntraI               | 10,339                    | 2021                         | 2024                             | 8,991                 | 14,428                     | 2,951                                                                      | 4,418                                                    | 7,369                                                                 |
| 18CJ927        | SESC                 | 4,416                     | 2020                         | 2021                             | 3,840                 | 318                        | 2,882                                                                      | -                                                        | 2,882                                                                 |
| 18CJ925        | MEP&M                | 20,722                    | 2021                         | 2024                             | 18,019                | 3,495                      | 1,930                                                                      | 2,389                                                    | 4,319                                                                 |
| 20AB203        | BLUEWBC              | 25,529                    | 2020                         | 2023                             | 22,199                | 8,303                      | 15,178                                                                     | 9,543                                                    | 24,721                                                                |
| 18CA727        | ALMARS               | 9,707                     | 2019                         | 2022                             | 8,441                 | 860                        | 5,234                                                                      | 1,555                                                    | 6,789                                                                 |
| 18BE002        | MARDS                | 9,977                     | 2018                         | 2021                             | 8,675                 | 1,323                      | 5,506                                                                      | 1,567                                                    | 7,073                                                                 |
|                |                      | 199,849                   | 30,293                       | 30,335                           | 172,468               | 48,523                     | 74,574                                                                     | 40,831                                                   | 115,405                                                               |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

**Nga buxheti i shtetit realizimi është 77% e planit vjetor .**

- Pagat jane realizuar në masën 99.8 %.
- Kërkimi Shkencor është realizuar në masën 72 % e planit vjetor.
- Shpenzimet operative janë realizuar në masën 52% e planit vjetor.
- Bursat (Transferta te individet) janë realizuar në masën 66 % e planit vjetor.

**Nga te ardhurat e veta realizimi është në masën 44% e planit vjetor.**

- Pagat janë realizuar në masën 62 %.
- Kërkimi Shkencor është realizuar në masën 66 % të planit vjetor.
- Shpenzimet operative janë realizuar në masën 79% të planit vjetor.
- Transferta me jashtë janë realizuar 90% e planit vjetor.
- (Transferta te individet) janë realizuar në masen 95%.

**Informacinin e mësipërm po e paraqesim ne formë tabelare sipas Udhësuesit të AKFAL nr. 75/3 prot. datë 11.07.2023**

- **Tabela 24.** Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Mësimdhënies për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606)

| Nr. | Tabela 24. Emërtimi                                                                                                     | Granti i Mësimdhënies /2022 |                |               |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|----------------|---------------|
|     |                                                                                                                         | Plani                       | Fakt           | %             |
|     | Studentë që ndjekin ciklin e parë të studimeve                                                                          | 459,932                     | 449,831        | 97.80%        |
|     | Studentë që përfitojnë bursa financiare si dhe mbështetje financiare për akomodim në shtëpiat e trajtimit të studentëve | 34,352                      | 22,661         | 65.97%        |
|     | <b>Totali</b>                                                                                                           | <b>494,284</b>              | <b>472,492</b> | <b>95.59%</b> |

- **Tabela 25.** Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Punës Kërkimore-Shkencore dhe i Veprimtarive Krijuese për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09770, kapitullin 01, 08,04,artikulli 604,602,231)

| Nr. | Tabela 25. Emërtimi i projektit |              |           | Grant Total/2022 |       |   | Projekti Total/2022 |     |                     |
|-----|---------------------------------|--------------|-----------|------------------|-------|---|---------------------|-----|---------------------|
|     |                                 | Kod Projekti | Kapitulli | Plan             | Fakti | % | Granti              | IAL | Vlera (Grant + IAL) |
|     |                                 |              |           |                  |       |   |                     |     |                     |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

|   |                                                |         |   |               |               |               |               |          |               |
|---|------------------------------------------------|---------|---|---------------|---------------|---------------|---------------|----------|---------------|
| 1 | Financim programe per bashkpunimin shkencor    | 91106AB | 8 | 5,699         | 3,782         | 66%           | 5,699         | 0        | 5,699         |
| 2 | Programe bashkpunimi me biznesin privat        | 91106AC | 8 | 2,262         | 0             | 0%            | 2,262         | 0        | 2,262         |
| 3 | Qender digjtale per profesionistet e Shendetit | 18BD920 | 1 | 6,840         | 6,840         | 100%          | 6,840         | 0        | 6,840         |
| 4 | TVSH projekti Entral                           | 18CJ922 | 1 | 343           | 338           | 99%           | 343           | 0        | 343           |
| 5 | TVSH projekti Knoëhub                          | 18CJ920 | 4 | 1,197         | 1,197         | 100%          | 1,197         | 0        | 1,197         |
| 6 | TVSH projekti Succes                           | 18CJ922 | 4 | 1,368         | 684           | 50%           | 1,368         | 0        | 1,368         |
| 6 | <b>Totali</b>                                  |         |   | <b>17,709</b> | <b>12,841</b> | <b>72.51%</b> | <b>17,709</b> | <b>0</b> | <b>17,709</b> |

**Tabela 26.** Për realizimin faktik të buxhetit nga Grantit i Politikave të Zhvillimit për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitulli 01, artikulli 230-231).

| Nr. | Tabela 26. Emërtimi                               | Kod Projekti | Kapitulli | Granti i Politikave të Zhvillimit |               |            |       |
|-----|---------------------------------------------------|--------------|-----------|-----------------------------------|---------------|------------|-------|
|     |                                                   |              |           | Plani                             | Fakt          | %          | Plani |
|     | Ndertimi I dy laboratoreve Digital                | 18BD407      | 1         | 8,908                             | 8,908         | 100%       |       |
|     | Perafrimi I kapaciteteve Akademike te mesimdhënie | 18BD408      | 1         | 6,853                             | 6,853         | 100%       |       |
|     | Ndërtimi i Godinës së re të FSH-së                | 18BD512      | 1         | 122,000                           | 0             | 0          |       |
|     | <b>Totali</b>                                     |              |           | <b>137,761</b>                    | <b>15,761</b> | <b>11%</b> |       |

## 5. Realizimi i buxhetit Janar–Shtator 2023.

Buxheti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për vitin 2023 është miratuar me vendim të Bordit të Administrimit nr. 8 datë 11.03.2022.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë operon me programet buxhetore si më poshtë

- a) 09450 program i aktivitetit të përditshëm
- b) 09470 program i projekteve dhe kërkimit shkencor

### 1. Artikujve buxhetor

- a) Artikulli 600 Shpenzime Paga
- b) Artikulli 601 Shpenzime sigurimesh



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
SENATI AKADEMIK

- c) Artikulli 602 Shpenzime operative
- d) Artikulli 605 Transferta me jashtë
- e) Artikulli 606 Bursa
- f) Artikulli 230 Studime projektive
- g) Artikulli 231 Investime

2. **Financimet**

- a) Financim i brendshëm
- b) Financim i huaj

Në zbatim të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 75 ,datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", granti për vitin buxhetor 2023 është detajuar me vendim të Bordit të Administrimit nr 1, datë 09.01.2023. Granti i mbartur nga viti 2022 për vitin 2023 është detajuar sipas shkresës së MAS nr. 2837/1 prot., datë 24.02.2023 "Dërgohet granti i mbartur për vitin 2023

**Gjatë Vitit 2023 janë dërguar fondet si më poshtë:**

- Sipas shkresës së MAS nr. 937/2 prot., datë 16.03.2023 "Dërgohet detajimi i buxhetit të vitit 2023, për shpenzimet kapitale".
- Sipas shkresës së MFE nr. 5838/1 prot., datë 04.04.2023 "Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2023" është dërguar fondi me qëllim mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer të cilët ndjekin programet e studimit që përbejnë prioritet kombëtar për vitin 2023,
- Sipas shkresës së MFE 9673/3 prot., datë 07.06.2023 shtesa e fondit të pagave në zbatim të VKM-ve për stafin akademik
